

*Korniza gjithpërfshirëse e
politikës mbi çështjen e
aftësisë së kufizuar në
Kosovë*

**Grupi punues mbi çështjen e aftësisë së kufizuar
3 dhjetor 2001**

Hyrje

Personat me aftësi të kufizuar në Kosovë, që sipas vlerësimeve ndërkombëtare mund të jenë 150 000 (kjo shifër është vlerësimi më i mirë dhe duhet verifikuar), jetojnë në kushte të varfërisë, izolimit dhe stigmës (njollosjes). Gjendja e tyre është keqësuar gjatë konfliktit dhe zhvendosjes së popullatës që ka mbizotëruar në Kosovë vitet e fundit.

Personat me aftësi të kufizuar në Kosovë për vite me rradhë kanë qenë të organizuar në kuadër të Handikos-it, organizatë jo-qeveritare lokale. Handikos-i ka qenë ofruesi kryesor i përkrahjes dhe shërbimeve rehabilituese për personat me aftësi të kufizuar dhe ka krijuar një rrjet të qendrave të bashkësisë dhe grupeve aktive lokale të personave me aftësi të kufizuar.

Një numër i OJQ-ve ndërkombëtare, duke përfshirë Handicap International (e emëruar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, si “organizatë udhëheqëse” ndërkombëtare mbi aftësinë e kufizuar), Këshilli Danez i Organizatave të personave me aftësi të kufizuar (DSI), OBSH (WHO), OXFAM, ministria për punë të jashtme e Finlandës etj, kanë përkrahur punën e HandiKOS-it në Kosovë si gjatë viteve të konfliktit poashtu edhe tani në procesin e paqës.

I udhëhequr nga ndryshimet e rëndësishme në të menduarit ndërkombëtar në qasjen e çështjes së aftësisë së kufizuar duke u bazuar në aspektin e të drejtave të njeriut, Handikos-i është angazhuar në procesin avokimit për pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë të personave me aftësi të kufizuar në shoqërinë kosovare. Procesi ndodh në kontekstin e iniciativave momentale të rekonstruimit dhe krijimit të institucioneve të përkohshme të vetë-qeverisjes dhe të politikave përcjellëse të procesit zhvillimor në Kosovë.

Nxjerrja e Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme nga përfaqësuesi i posaçëm i sekretarit gjeneral të KB me 15 maj të vitit 2001, ofron një qeveri sistemi i së cilës bazohet në të drejtat e njeriut, duke penguar në këtë mënyrë çdo formë të diskriminit. Edhe pse aftësia e kufizuar nuk është përmendur në mënyrë të veçantë në Kornizën Kushtetuese, klauzolat mbi të drejtat dhe liritë e njeriut në instrumentet ndërkombëtare siç është konventa për të drejtat e njeriut si dhe dokumente të tjera të cilat nuk merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me sferën e aftësisë së kufizuar janë shpallur si “të zbatueshme si pjesë e kornizës Kushtetuese në Kosovë”.

UNIMK-u, në dhjetor të vitit 2000, në kuadër të administratës së vet formoi grupin punues (Task Force) mbi aftësinë e kufizuar, detyra kryesore e të cilit ka qenë të zhvillojë një strategji gjithpërfshirëse mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë, e cila do të jetë në pajtim me Rregullat Standarde të KB për barazimin e mundësive të personave me aftësi të kufizuar. Strategjia mbi çështjen e aftësisë së kufizuar do të zgjerojë qasjen e çështjes së aftësisë së kufizuar duke u bazuar në aspektin e të drejtave e njeriut që është edhe njëri nga qëllimet e Kornizës Kushtetuese.

Grupi punues (Task Force) përbëhet nga përfaqësues të HandiKOS-it, grupeve të tjera të aftësisë së kufizuar, Handicap International, dhe përfaqësues të disa departamenteve të administratës së përkohshme të përbashkët. Zhvillimi i Kornizës gjithpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë do të jetë një proces pjesëmarrës në të cilin do të përfshihen personat me aftësi të kufizuar, përkrahësit dhe aktorë të tjerë.

Qëllimi është që grupeve të aftësisë së kufizuar t'u ofrohet pjesëmarrje në planifikimin e politikës në mënyrë që nevojat e personave me aftësi të kufizuar të merren parasysh sa herë që të formulohet politika. Janë bërë propozime (që varet nga burimet në dispozicion) për krijimin e një Zyre mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në zyrën e Kryeministrit me qëllim të implementimit të Kornizës gjithpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në të gjitha nivelet e qeverisë së Kosovës. Po ashtu tentohet që grupi punues i cili funksionon në kuadër të UNMIK-ut të transformohet në Këshill mbi çështjen e aftësisë së kufizuar, e cila do të shërbejë si strukturë konsultative, mendimdhënëse dhe mbikqyrëse mbi çështjet e aftësisë së kufizuar.

B. ANALIZIMI I SITUATËS

B.1 Shtrirja e aftësisë së kufizuar në Kosovë.

Në Kosovë ka mungesë serioze të informatave të sigurta mbi natyrën dhe shtrirjen e aftësisë së kufizuar.

Statistikat nuk janë të sigurta për disa arsye:

1. ekzistojnë definicione të ndryshme mbi aftësinë e kufizuar;
2. ekziston mungesë serioze e njohurive mbi lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar;
3. janë përdorur teknologji të ndryshme kërkimore në mbledhjen e informatave;
4. ekzistojnë qëndrime negative të shoqërisë ndaj çështjes së aftësisë së kufizuar;
5. infrastruktura e shërbimeve në rajonet rurale është e varfër, por edhe dhuna (në vende dhe kohë të caktuara) ka penguar mbledhjen e informatave, kështu që ato kanë ndikuar në pasqyrën e përgjithshme.

Megjithatë, disa statistika të vlefshme na i ofron Programi për Zhvillim I KB (UNDP). UNDP, vlerëson se, në vitin 1990, 5,2% e popullatës së përgjithshme në botë ka përjetuar ndonjë kufizim të lehtë ose të rëndë të aftësisë. Kufinj të sillen prej 7.7% në vendet e zhvilluara deri 4.5% në vendet më pak të zhvilluara. Statistikat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë janë më të përgjithshme dhe ato paraqesin të gjitha dëmtimet, jo vetëm ato të moderuara dhe të rënda, duke përfshirë një gamë prej 10 deri 15% për shoqëritë në zhvillim, me një shkallë më të lartë të shtrirjes në vendet e zhvilluara.

Në sektorin e arsimit, regjistrimi i fëmijëve në Kosovë në fund të vitit shkollor 1999/2000 është vlerësuar të jetë 400.000. Nga vlerësimet e dhëna në lidhje

me kufizimin e rëndë të aftësisë (1%), numri i mundshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuar është 4000. Aktualisht, numri i fëmijëve dhe të rinjve të cilët vijojnë mësimin në 14 klasë ekzistuese për nxënësit me aftësi të kufizuar në kuadër të shkollave speciale dhe atyre të rregullta, është më i vogël se 500.

Është me rëndësi të theksohet se aftësia e kufizuar nuk prek vetëm individin por edhe familjen e tij dhe rrethin. Kështu, ndikimi i aftësisë së kufizuar është më i madh sesa që sugjerojnë shifrat e paraqitura më lartë.

B.2 Përrjashtimi

Përrjashtimin që kanë përjetuar personat me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre është rezultat i një sërë faktorësh, psh:

- jobarazia ekonomike dhe politike;
- dhuna dhe lufta;
- pikëpamjet e shoqërisë të cilat kanë krijuar stereotipe për personat me aftësi të kufizuar si persona të varur dhe që kanë nevojë për përkujdesje ose madje edhe nuk ia vlen kujdesi për ta dhe mos vlerësimi i tyre si burim i shoqërisë.
- Prirja profesionale ndaj shërbimeve të specializuara dhe të veçuara (shpesh për njerëzit me aftësi të kufizuar specifike) e cila supozon se njerëzit me aftësi të kufizuar nuk mund të integrohen në shoqëri as në aspektin social e as në atë ekonomik;
- Korniza legjislative joadekuate, e cila ka sanksionuar dhe përforcuar pengesat përrjashtuese në profile të ndryshme (si p.sh. punësim, arsimim).
- Mungesa e qasjes në arsimim, bën që shumë të rritur me aftësi të kufizuar të kenë shkallë të ultë të arsimimit dhe për këtë arsye të mos mund të kenë pjesëmarrje të plotë as në aspektin ekonomik e as në atë shoqëror.

Legjislacioni ka kontribuar në përrjashtimin e personave me aftësi të kufizuar nga shoqëria. Së pari, legjislacioni shpesh dështon në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe së dyti, përrmes legjislacionit janë krijuar pengesa të cilat pengojnë personat me aftësi të kufizuar të kenë mundësi të barabarta në qasje.

Njëra nga arsyet kryesore pse diskriminimi legjislativ ende vazhdon të jetë prezent është se diskriminimi nuk kuptohet gjithmonë vetëm me leximin nga statuti. Problemet shpesh lindin kur fillojnë të aplikohen statutet ose rregulloret. Kjo përrfshin:

- Mënyën si janë përrpilu rregulloret për qeverisjen e akteve të veçuanta;
- Mënyra se si janë të administruara aktet dhe/ose rregulloret e tyre;
- Interpetimi joadekuat dhe/ose injorues i ligjit;
- Mbikqyrja e dobët e ligjit;
- Qasje joadekuate në ligj.

Ky përrjashtim ka si pasojë:

- Rritjen e varfërisë;
- Zvoglimin e qasjes në arsim;
- Rritjen e papunësisë;
- Rritjen e shkallës së analfabetizmit;

Një faktor i rëndësishëm që duhet të merret parasysh është tendenca e shoqërisë për t'i shikuar personat me aftësi të kufizuar si grup të veçantë. Kështu, personat në karrocë janë bërë përfaqësues të popullarizuar të personave me aftësi të kufizuar. Kjo injoron shumëllojshmërinë e aftësisë së kufizuar dhe gjithashtu shumëllojshmërinë e nevojave që kanë njerëzit me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Përveç kësaj, duhet pranuar se në kuadër të bashkësisë së aftësisë së kufizuar ekzistojnë grupe të cilët kanë përjetuar diskriminim më të madh në krahasim me të tjerët, p.sh. gratë me aftësi të kufizuar, fëmijët me aftësi të kufizuar, njerëzit me dëmtime mendore dhe intelektuale, njerëzit me aftësi të kufizuar të cilët janë zhvendosur për shkak të dhunës ose luftës. Këto grupe kanë përjetuar dhe ende janë duke përjetuar një shkallë të lartë të përjashtimit nga mjedisi shoqëror, ekonomik dhe ai politik. Kjo kërkon një plan të posaçëm me qëllim të ndreqjes së pabarazive nga e kaluara dhe e tashmja. Gjithashtu, vëmendje të posaçme duhet t'i kushtohet kuptimit dhe shqyrtimit të rrethanave të cilat kanë shpër në cenueshmërinë ekstreme të këtyre grupeve.

B.3 Qasjet në çështjen e aftësisë së kufizuar

Shpesh aftësia e kufizuar është cilësuar si mungesë, negacion (mohim) i asaj se çka duhet të jetë jeta "normale", dhe përjetimi i aftësisë së kufizuar, në të gjitha llojet e shoqërisë, nga ajo antike deri te ajo moderne, shpesh ka shkaktuar shqetësim, frikë dhe bestytni. Këto forma ekstreme të frikës dhe injorancës shpesh kanë rezultuar me mohimin e vetëdijshëm dhe të pavetëdijshëm të aftësisë së kufizuar, si në sistemin fashist dhe atë Sovjetik poashtu edhe në shoqëritë demokratike ku aftësia e kufizuar është konsideruar dhe ende konsiderohet si diçka e turpshme dhe si diçka që duhet fshehur.

Modeli mjekësor dhe ai i mëshirës

Modeli mjekësor dhe ai i mëshirës mbi aftësinë e kufizuar, aftësinë e kufizuar e sheh si fatkeqësi individuale e cila mund të shërohet apo të zbutet përmes intervenimeve të specializuara profesionale. Prandaj, historikisht aftësia e kufizuar kryesisht është cilësuar si çështje mjekësore dhe e mirëqenies dhe prandaj intervenimi i shtetit në këtë aspekt në shkallë të madhe është kanalizuar nëpërmjet institucioneve mjekësore dhe atyre të mirëqenies. Orientimi profesional, qoftë mjekësor ose social, para së gjithash është orientim profesional teknik i cili problemin më shumë e trajton si problem që i takon individit me aftësi të kufizuar dhe i cili duhet klinikisht të "riparohet" apo fiksohet, sesa si burim primar i përjashtimit dhe diskriminimit. Përgjegjësia për "kujdesin" ndaj personave me aftësi të kufizuar në përgjithësi ka rënë mbi institucionet e veçuara, të specializuara, që finansohen nga qeveria dhe/ose shoqëria civile. Angazhimi në shqyrtimin e çështjes së aftësisë së kufizuar në sektorët e tjerë të përgjegjësisë së qeverisë ka qenë shumë i vogël ose nuk ka ekzistuar fare.

Përveç kësaj, modeli mjekësor dhe ai i mëshirës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar do të thotë se organizatat e personave me aftësi të kufizuar zakonisht

kontrollohen nga persona pa kufizim të aftësisë të cilët ofrojnë shërbime personave me aftësi të kufizuar dhe të cilët janë të interesuar të krijojnë një mjedis që do të "kujdeset" më shumë për grupet e ndryshme të personave me aftësi të kufizuar. Qëllimi i tyre zakonisht është të ofrojnë trajtime, ose të krijojnë alternativa lidhur me lypjen ose "fshihen". Filozofia ka qenë që personat me aftësi të kufizuar nuk duhet t'i urrejmë apo të frikësohemi nga ata, por duhet të kemi mëshirë ose t'u ndihmojmë si pjese e "atyre që meritojnë mëshirë". Në përgjithësi, nevojat e zakonshme si dinjiteti, respekti dhe trajtimi i barabartë nuk janë marrë parasyshtë.

Qëndrimet e shoqërisë që janë krijuar si rezultat i kuptimit të çështjes së aftësisë së kufizuar si çështje mjekësore dhe e mirëqenies kanë pushtuar të gjitha fushat e shoqërisë. "Nevoja për kujdesje të specializuar" ka rezultuar me izolimin e personave me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre nga bashkësia dhe aktivitetet e përditshme. Varshmëria nga ndihma shtetërore ka varfëruar personat me aftësi të kufizuar dhe seriozisht ka reduktuar kapacitetet dhe mirëbesimin e tyre për të bashkëpunuar në nivel të barabartë me njerëzit e tjerë të shoqërisë. Kjo i ka penguar ata të kenë qasje në të drejtat themelore shoqërore, politike dhe ekonomike.

Modeli social dhe i të drejtave të njeriut

Modeli social dhe i të drejtave të njeriut mbi aftësinë e kufizuar, aftësinë e kufizuar e cilëson si problem shoqëror që kërkon përgjigje nga shoqëria. Personat me aftësi të kufizuar janë bashkuar me qëllim për t'u mobilizuar dhe organizuar. Qëllimi i tyre është krijimi i një lëvizjeje të fuqishme civile të organizatave që kontrollohen nga vetë personat me aftësi të kufizuar. Në lëvizjen për të drejtat e aftësisë së kufizuar kryesore është paraqitja e aftësisë së kufizuar si çështje e të drejtave të njeriut dhe e zhvillimit në përgjithësi. Kjo shpjen në njohjen dhe pranimin e aftësisë së kufizuar si pjesë normale e jetës, që personat me aftësi të kufizuar janë qytetarë të barabartë dhe prandaj duhet të gëzojnë të drejta dhe përgjegjësi të njëjta. Kjo nënkupton që shpërndarja e mjeteve duhet të bëhet në bazë të nevojave dhe duhet të ofrojë që çdo individ të ketë mundësi të barabartë për pjesëmarrje në shoqëri.

Në kuadër të shoqërisë, përveç të drejtave, njerëzit me aftësi të kufizuar duhet të kenë edhe obligime të njëjta. Prandaj personave me aftësi të kufizuar duhet t'u ofrohet përkrahja e domosdoshme që do t'u mundësonte përmbushjen e obligimeve të tyre. Kjo do të thotë që shoqëria duhet të zmadhojë pritjet e veta nga njerëzit me aftësi të kufizuar.

Qasja e çështjes së aftësisë së kufizuar duke u bazuar në aspektin e të drejtave të njeriut dhe zhvillimit përqëndrohet në mënjanimin e pengesave për pjesëmarrje të barabartë dhe në eliminimin e diskriminimit të bazuar në aftësinë e kufizuar.

Modeli social dhe i të drejtave të njeriut mbi aftësinë e kufizuar sugjeron që problemet kolektive të personave me aftësi të kufizuar ekzistojnë për shkak të formës komplekse të diskriminimit institucional. Ky diskriminim është fundamental për mënyrën se si shoqëria mendon dhe vepron. Rrethanat në të cilat ndodhen personat me aftësi të kufizuar dhe diskriminimi me të cilin ata

ballafaqohen janë fenomene të cilat i ka krijuar shoqëria dhe pak ka të bëjë me dëmtimet e personave me aftësi të kufizuar. Prandaj, lëvizja për të drejtat e aftësisë së kufizuar beson që “ilaçi” për “problemin” e aftësisë së kufizuar qëndron në restrukturimin e shoqërisë, frikës, miteve dhe stereotipeve të cilat reflektojnë reagimin e shoqërisë ndaj aftësisë së kufizuar.

Modeli social dhe i të drejtave të njeriut mbi çështjen e aftësisë së kufizuar nënkupton ndryshimin e paradigmës në aspektin e krijimit të domethënies mbi aftësinë së kufizuar dhe reagimit ndaj saj. Në këtë mënyrë:

- Përjetimi i aftësisë së kufizuar është e trajtuar si normale, si pjesë rutinore e jetës, dhe jo si shmangie apo si një përvojë e cila duhet parandaluar ose madje ndryshuar. Kështu, disa persona të shurdhër do të vendosin të mos kenë implantime kohleare sepse kjo do t’ua merrte identitetin unik kulturor të tyre.
- Shkallët e ndërtesës janë ato të cilat kufizojnë përdoruesin e karrocës, e jo karroca.
- Pamundësia e shkollave të zakonshme të merren me shumëllojshmërinë në klasa, është ajo e cila i detyron fëmijët me aftësi të kufizuar të shkojnë në shkolla speciale.
- Personat e shurdhër janë të hendikepuar nga njerëzit që nuk janë të shurdhër dhe të cilët nuk e flasin gjuhën e shenjave, dhe zgjidhja është të tjerët të mësojnë gjuhën e shenjave e jo të shurdhërit të shërohen, të flasin, apo të mësojnë të lexojnë nga buzët.
- Personat me aftësi të kufizuar të cilët konkurrojnë për ndonjë vend pune duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, dhe duhet t’u sigurohen kushte bazë siç janë shtegjet e pjerrëta (pjerrinat), software, trajnim në punë apo përkthyes.

Për këtë arsye modeli social dhe i të drejtave të njeriut thekson dy gjëra: gabimet e shoqërisë në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe, aftësitë dhe mundësitë e vetë personave me aftësi të kufizuar.

Rezultat i kësaj është qasja e cila kërkon burime për të bërë transformimin e të ashtuquajturave mirësive dhe shërbimeve “të zakonshme”, me qëllim të pengimit të diskriminimit dhe të krijimit të një mjedisi të shumëllojshëm. Posaçërisht në një zonë post-konfliktuale siç është rasti në Kosovë, modeli social dhe ai i të drejtave të njeriut nënkupton që në rindërtimin dhe zhvillimin e shoqërisë sonë të përfshihet njohja dhe përpjekja për shqyrtimin e nevojave zhvillimore të personave me aftësi të kufizuar në kuadër të zhvillimit përfshirës.

Ndryshimi i paradigmës (nga modeli mjekësor në atë social/modelin për të drejtat) në masë të madhe është realizuar përmes zhvillimit të organizatave të fuqishme të personave me aftësi të kufizuar. Pjesa kryesore e konceptit të modelit social mbi aftësinë e kufizuar është parimi i vetë-përfaqësimit nga ana e njerëzve me aftësi të kufizuar nëpërmjet OPAK-ve (organizatave të personave me aftësi të kufizuar). Kjo nënkupton edhe ndryshimin e përkrahjes financiare të cilën e siguron qeveria. Shërbimet duhet të sigurohen në kontekst të fuqizimit personal, social dhe ekonomik dhe jo në kontekst të varshmërisë.

C. Skenari ndërkombëtar

Viti 1981 nga ana e KB-ara është shpallur si vit ndërkombëtar i personave me aftësi të kufizuara. E arritura kryesore e këtij viti ka qenë miratimi i programit botëror të veprimit lidhur me personat me aftësi të kufizuara gjatë dekadës së personave me aftësi të kufizuara të KB-ara (1983-1993). Qëllimi i programit botëror të veprimit ka qenë avancimi i masave efektive në parandalimin e atësisë së kufizuara, rehabilitimin dhe realizimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara .

KB-ara kanë ndihmuar në përpilimin e rregullave standarde për barazimin e mundësive të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që qeverive t'u japin udhëzime të qarta në lidhje me akcionet që duhet ndërmarrë. Rregullat standarde janë miratuar nga asambleja e përgjithshme e KB-ara më 20 dhjetor të vitit 1993.

Qëllimet e rregullave standarde

Qëllimet e rregullave standarde, janë si në vijim:

1. Ato nënkuptojnë një angazhim të fortë moral dhe politik të shtetit në ndërmarrjen e aksioneve me qëllim të barazimit të mundësive të personave me aftësi të kufizuara.
2. Ato ofrojnë një instrument në hartimin e politikës dhe aksionit. Qëllimi është që të gjithë personave me aftësi të kufizuara t'u mundësohen të drejta dhe përgjegjësi të njëjta sikurse edhe qytetarëve të tjerë.
3. Ato vënë në dukje aspektet më kyçe të politikës sociale në sferën e aftësisë së kufizuara dhe sigurojnë modele mbi proceset politike vendim-marrëse për arritjen e mundësive të barabarta.
4. Ato propozojnë mekanizma kombëtar për bashkëpunim të ngushtë midis shteteve, organeve të KB-ara, OJQ-ve dhe OPP-ve.

Objektivat e rregullave standarde

Objektivat e rregullave standarde:

1. Theksimin e domosdoshmërisë së njohurive dhe përvojave adekuate mbi kushtet dhe nevojat e veçanta të personave me aftësi të kufizuara në ndërmarrjen e të gjitha aksioneve në sferën e aftësisë së kufizuara.
2. Theksimin e nevojës që qëllimi kryesor i zhvillimit socio-ekonomik të jetë procesi përmes të cilit çdo aspekt i organizimit të shoqërisë do të ketë qasje për të gjithë.
3. Vënien në dukje të aspekteve kyçe të politikës sociale në sferën e aftësisë së kufizuara duke përfshirë, sipas nevojës, inkurajimin aktiv të bashkëpunimit teknik dhe atij ekonomik.
4. Ofrimin e modeleve për procesin politik të vendim-marrjes, të domosdoshme për arritjen e mundësive të barabarta duke pasur parasysh: ndryshimet e mëdha të niveleve teknike dhe ekonomike; faktin që procesi duhet të reflektojë kuptimin thelbësor të kontekstit

kulturor në kuadër të cilit ai ndodh si dhe rolin kyç të personave me aftësi të kufizuar në të.

5. Propozimin e mekanizmave kombëtar për bashkëpunim të ngushtë midis shteteve, organeve të sistemit të KB-ara, trupave të tjerë ndërqeveritar dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuar.

Rregullat standarde për barazimin e mundësive të personave me aftësi të kufizuar dhe programi botëror i aksionit të cilat i përkasin personave me aftësi të kufizuar do të jenë dokumente me të cilat do të udhëhiqet zhvillimi, implementimi dhe mbikqyrja e Kornizës gjithpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar.

Përveç rregullave standarde ekzistojnë edhe disa dokumente të rëndësishme ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me qasjen në çështjen e aftësisë së kufizuar duke u bazuar në aspektin e të drejtave të njeriut. Këto janë:

Koventat mbi të drejtat e fëmiut, 1989 :

- e drejta e fëmiut me aftësi të kufizuar në arsimim dhe trajnim me qëllim të arritjes së shkallës më të lartë të pavarësisë dhe integritit social ;
- arsimimi duhet të synojë në zhvillimin e personalitetit, talenteve dhe aftësive mendore dhe atyre fizike të fëmiut sa më shumë që të jetë e mundur ;

deklarata e përbashkët botërore mbi arsimin për të gjithë, 1990.

- arsimi për të gjithë ;
- dallimet individuale pranohen si sfidë dhe jo si problem.

D Korniza gjithpërfshirëse e politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar

D.1 Vizioni: Një shoqëri demokratike e bazuar në të drejtat e njeriut

Në një shoqëri demokratike, e cila bazohet në të drejtat e njeriut, nevojat e çdo qytetari përbëjnë bazën e planifikimit dhe politikës dhe, sistemet e përgjithshme dhe institucionet e shoqërisë kanë qasje për të gjithë. Përmes organizimit të strukturave të shoqërisë në mënyrë që ato të plotësojnë nevojat e të gjithëve, shoqëria mobilizon potencialet e të gjithë qytetarëve të saj dhe me këtë fuqizon potencialet e saja zhvillimore.

Personat me aftësi të kufizuar janë pjesë natyrale dhe integrale e shoqërisë në tërësi, dhe atyre duhet t'u ofrohet mundësia që përmes përvojës, talenteve dhe kapaciteteve të tyre të kontribuojnë në zhvillimin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Meqenëse Kosova ballafaqohet me një sfidë të madhe në ruajtjen e të drejtave etnike dhe të minoriteteve, personat me aftësi të kufizuar duhet të përfshihen në procesin e ndërtimit të një shoqërie për të gjithë ku qytetarët pa marrë parasyshë prejardhjen dhe aftësitë e ndryshme të tyre do të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.

Disa struktura demokratike që janë duke u zhvilluar në Kosovë sigurojnë një kornizë për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar, ku definimi,

transmetimi dhe mbikqyrja e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuar në masat dhe programet e veçanta mbeten sfidë kryesore. Rregullat standarde janë instrumenti kryesor në udhëheqjen e politikës publike për sigurimin e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuar. Ato gjithashtu do t'i ndihmojnë qeverisë në krijimin e një ambienti të përshtatshëm i cili do të shpie në pjesmarrjen e plotë dhe në barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar në të gjitha nivelet e shoqërisë.

D.2 Objektivat

Objektivat e përgjithshme të kornizës gjithpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë, përfshijnë:

1. Lehtësimin e integritit të të drejtave, vlerave dhe përvojave të personave me aftësi të kufizuar në strategjitë, planifikimin dhe programet e zhvillimore të qeverisë ;
2. Zhvillimin e një sistemi menaxhues integral në bashkërendimin e planeve në sferën e aftësisë së kufizuar, implementimin dhe mbikqyrjen e funksioneve të ndryshme në të gjitha sferat e qeverisë;
3. Zhvillimin e strategjive për aftësimin e kuadrove të cilat do të rrisin aftësitë e qeverisë në të gjitha nivelet e implementimit të rekomandimeve që gjenden në kornizën gjithpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar.
4. Programin për edukim publik dhe ngritje të vetëdijës që ka për qëllim ndryshimin e parajkykimeve fundamentale në shoqërinë e Kosovës.
5. Zhvillimin e strukturave lokale siç është Këshilli mbi çështjen e aftësisë së kufizuar dhe pilot projekteve që lidhin zhvillimet e strategjisë dhe politikës me iniciativat e planifikimeve vepruese duke përfshirë të gjithë palët (OPAK-ët, qeveritë, sektorin privat).

D.3 Parimet

Parimet mbi të cilat bazohet strategjia, përfshijnë:

- **Vetë-përfaqësimin**

Parimi fundamental i cili krijon pamjen e lëvizjes për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë dhe në botë, është e drejta për vetë-përfaqësim. Kjo do të thotë që në krijimin e strategjive të qeverisë duhet të shfrytëzohet vendosmëria kolektive dhe urtësia e personave me aftësi të kufizuar. Me njohjen e këtij parimi, qeveria do të njohë rolin e organizatave të personave me aftësi të kufizuar dhe përfaqësuesit e tyre në procesin e vendim-marrjes. Me këtë do të sigurohet që vendimet e miratuara dhe të implementuara të janë të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar .

- **Integrimi**

Historikisht, çështjet e aftësisë së kufizuar kanë qenë të zgjidhura në mënyrë të fragmentuar, parciale. Ky ka qenë një nga faktorët kryesorë që ka kontribuar në anashkalimin e personave me aftësi të kufizuar dhe në varfërinë e tmerrshme në të cilën ndodhet pjesa më e madhe e tyre. Nëse nevojat e personave me aftësi të kufizuar shqyrtohen në mënyrë efektive,

çështja e aftësisë së kufizuar duhet plotësisht të integrohet në parimet, strategjitë dhe aktivitetet e të gjitha programeve të qeverisë. Me këtë do të sigurohet që efektet nga e kaluara të cilat kanë ndikuar negativisht në personat me aftësi të kufizuar, të çrrënosjen nga procesi i përhershëm i rindërtimit.

- **Qëndrueshmëria**

Finansimi i Kornizës gjithpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar, si pjesë e rindërtimit dhe zhvillimit, duhet të integrohet në burimet potenciale të finansimit afatgjatë qoftë prej sektorit politik ose atij privat. Të gjitha politikat dhe planet e zhvilluara duhet të jenë efektive.

E. UDHËZUESIT POLITIKË

E.1 Arsimi publik dhe ngritja e vetëdijes

Njëra nga pengesat më të mëdha me të cilën ballafaqohen personat me aftësi të kufizuar kur tentojnë të kyçen në programet e rëndomta dhe të krijojnë qasje të reja janë mungesa e përvojës dhe qëndrimet negative. “Frika, mitet dhe stereotipet” janë ato të cilat shpiejnë drejt përjashtimit dhe anashkalimin e personave me aftësi të kufizuar nga shoqëria. Ndryshimi i qëndrimeve nuk është diçka që ndodh në mënyrë automatike apo spontane, në realitet ai është një proces kompleks.

Objektiva e politikës është:

Të implementojë programe për vetëdijësim publik të cilët do të krijojnë një mjedis pozitiv dhe të përshtatshëm në të cilin do të respektohet dhe çmohet shumëllojshmëria.

Strategjitë për arsimim dhe vetëdijësim publik përfshijnë:

- Pozicionimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar si aspekt vlerësimi të diferencave si një nga qëllimet e përbashkëta të cilat Kosova mundohet t'i arrijë në të gjitha bashkësitë etnike. Vlera e aftësisë së kufizuar qëndron në atë se ajo është një përvojë e përbashkët e cila ekziston në të gjitha bashkësitë, që do të thotë se mund të shfrytëzohet si një mundësi e realizimit të komunikimit dhe bashkëpunimit.
- Zhvillimin e integritit multisektorial të strategjisë së vetëdijësimit mbi çështjen e aftësisë së kufizuar e cila do të përcjellte porosinë bashkësive të ndryshme përmes mediave të ndryshme.
- Implementimin e projekteve për ngritjen e vetëdijës së gazetarëve dhe transmetuesve publik mbi çështjen e aftësisë së kufizuar duke përfshirë këtu edhe porosinë mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar si diçka të kundërt me përfytyrimet e "mëshirës " apo "heroizmit" dhe përdorimin pozitiv të modeleve nga të gjitha grupet;
- Programet për ngritjen e vetëdijës ndaj çështjes së aftësisë së kufizuar në kuadër të çdo funksioni të qeverisë.
- Rritja e pranisë së personave me aftësi të kufizuar në media dhe shoqëri.

E.2 Parandalimi

Njëra nga gurthemet e politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar është parandalimi i cili integron qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut, sipas së cilës çdo jetë ka vlerë, të gjithë njerëzit kanë mundësi zgjedhjeje në lidhje me të drejtat e riprodhimit dhe shumë dëmtime mund të parandalohen apo të zbuten përmes zbulimit dhe planifikimit në kohën e duhur.

Objektiva e politikës është:

Zhvillimi i programeve parandaluese primare dhe sekondare të cilat kufizojnë sëmundjet dhe aksidentet që shkaktojnë kufizim të aftësisë.

Strategjitë për parandalim përfshijnë:

- Avancimin e mënyrës së shëndoshë të jetesës në shtëpi, shkollë, vendin e punës dhe në terren.
- Masat parandaluese siç janë imunizimi, mbrojtja nga aksidentet, mbrojtja në vendin e punës.
- Shmangien e konflikteve, luftës dhe dhunës si dhe mbështetjen e iniciativave të paqës.
- Zvoglimin e varfërisë përmes përmirësimeve të caktuara në statusin arsimor, ekonomik dhe social të të varfërve.
- Përmirësimin e shërbimeve mjekësore duke përfshirë identifikimin dhe intervenimin e hershëm, këshillimin gjenetik të bazuar në normat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktikën më të mirë, si dhe trajtim mjekësor efektiv në urgjencë.
- Zvoglimin e aksidenteve në trafik dhe në vendin e punës përmes përshtatjes së ambientit.
- Mirratimin dhe implementimin e legjislacionit dhe rregullave për të parandaluar aksidentet në rrugë dhe në punë.
- Zhvillimin e grupeve këshilluese në zonat rurale.

E.3 Kujdesi shëndetësor

Për barazimin e mundësive të personave me aftësi të kufizuar thelbësore është ofrimi i shërbimeve të përshtatshme mjekësore në tre nivelet, atë primar, sekondar dhe terciar. Shërbimet e tilla duhet të përfshijnë mjekësinë familjare dhe kujdesin shtëpiak të bashkësisë, atë spitalor, shërbimet fizikale dhe të rehabilitimit të cilat duhet të ofrohen në bashkëpunim me OJQ-të dhe OPAK-ët. Format e veçanta të ndihmës të cilat ofrohen në ambulance ose shtëpi, preferohen në kujdesin spitalor. Besohet që një qasje e këtillë do të zmadhojë qasjen në të gjitha shërbimet mjekësore dhe ato të shëndetit mendor (psikologjik/psikiatrik).

Shërbimet e tilla duhet të jenë në përputhje me dokumentet/politikën tjera siç është politika e shëndetësisë së Kosovës, politika e shëndetit mendor të Kosovës dhe propozimi për mjekësinë fizikale si dhe për politikën dhe strategjinë e rehabilitimit në Kosovë.

Objektiva e politikës është:

Zhvillimi i një sistemi të përgjithshëm gjithpërfshirës të kujdesit shëndetësor, në të gjitha nivelet e kujdesit, që është i ndjeshëm ndaj nevojave të përgjithshme dhe specifike të kujdesit mjekësor të personave me aftësi të kufizuar dhe që është në përputhshmëri me fazën e hershme të zhvillimit të politikës së shëndetësisë në Kosovë.

Strategjitë përfshijnë:

- Masat për identifikimin dhe zvogëlimin e diskriminimit të bazuar në aftësinë e kufizuar në sektorin e shëndetësisë.

- Kujdes mjekësor gjithpërfshirës për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, duke përfshirë qasjen e lirë në mjetet ndihmëse si dhe në shërbimet e rehabilitimit.
- Shërbime të specializuara afat shkurtë të rehabilitimit mjekësor me qasje për të gjithë, posaçërisht për ata që janë të lënduar si rezultat i dhunës, me të cilat avancohet rehabilitimi funksional dhe integrimi sa më i shpejtë në familje dhe bashkësi dhe jo shërbime të izoluar dhe të specializuara afat-gjata për ndihmë sociale dhe strehim.
- Zhillimin e normave dhe standardeve minimale për ndërtimin e kapaciteteve shëndetësore dhe qendrave rehabilituese me qëllim të sigurimit të qasjes së lirë.
- Strategjitë përkatëse të komunikimit në vendet e ofrimit të shërbimeve duhet t'iu sigurojnë qasje të barabartë personave me aftësi të kufizuar në komunikim, në të pamur apo në të dëgjuar.
- Zhvillimin e programeve trajnuese për personelin mjekësor dhe personelin e përgjithshëm të shëndetësisë, për të lehtësuar dhe kuptuar ofrimin e shërbimeve të shëndetësisë në kuadër të modelit social dhe atij të të drejtave të njeriut.
- Bashkëpunimi me sektorin e arsimit në ofrimin e mjeteve dhe shërbimeve ndihmëse për arsimin përfshirës.

E.4 Rehabilitimi i bazuar në bashkësi

Modeli social dhe i të drejtave të njeriut mbi çështjen e aftësisë së kufizuar propozon një rol më qendror për personat me aftësi të kufizuar në planifikimin, zhvillimin, implementimin dhe mbikqyrjen e shërbimeve të rehabilitimit. Me fjalë të tjera, do të ketë një zhvendosje të pushtetit nga profesionistët te personat me aftësi të kufizuar. Kjo nënkupton ofrimin e shërbimeve përmes të cilave nevojat e personave me aftësi të kufizuar plotësohen plotësisht. Për këtë arsye, rehabilitimi i bazuar në bashkësi (RBB-ja) duhet të formojë bazën e strategjisë së rehabilitimit.

Objektiva e politikës është:

Ngritja e vetëdijes mbi RBB-në dhe krijimi i qasjes në shërbimet përkatëse të rehabilitimit të bazuara në qasjen e RBB përmes zhvillimit ekzistues të rrjetit të Handikos-it.

Strategjitë për rehabilitim përfshijnë:

- Zhvillimin e planprogramit dhe trajnimin përkatës të punëtorëve të bashkësisë përfshirë këtu, terapinë primare, rehabilitimin angazhues psiko-social dhe parandalimin.
- Zhvillimin e sistemit të decentralizuar të ofrimit të shërbimeve përmes përkrahjes së Qendrave të bashkësisë.
- Bashkëpunimin inter-sektorial dhe sistemin referues në nivelin lokal.
- Sigurimi i mjeteve të përshtatshme dhe të mundshme ndihmëse.
- Partneritetet midis personave me aftësi të kufizuar dhe profesionistëve të cilët adresojnë nevojat reale të personave me aftësi të kufizuar.

E.5 Qasja pa pengesa (e lirë)

Mënyra se si është zhvilluar dhe organizuar ambienti në masë të madhe kontribuon në shkallën e pavarësisë dhe barazisë së personave me aftësi të kufizuar.

Në shoqëri ekziston një numër i madh i pengesave të cilat pengojnë personat me aftësi të kufizuar të kenë mundësi të barabarta me të tjerët. Për shembull: pengesat arkitektonike; ¹pamundësi të qasjes në pikat ku ofrohen shërbimet; ²hyrjet e papërshtatshme; ³planifikimi jo i mirë i qytetit; ⁴dizajnimi jo i mirë i pjesës së brendshme dhe transporti i papërshtatshëm publik.

Duhet të theksohet se pengesat përfshijnë gjithashtu qasjen në informata dhe komunikim; p.sh. të folurit është një pengesë për personat të cilët përdorin gjuhën e shenjave.

Problemet kryesore të qasjes në Kosovë janë :

- Ndërtesat private dhe ato publike nuk janë të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar.
- Profesionistët të cilët merren me planifikim nuk njohin detajet specifike të cilat janë të nevojshme në sigurimin e një ambienti pa pengesa;
- OJQ-të dhe agjencitë tjera nuk kanë politikë të qartë për sa i përket përshtatshmërisë së mjedisit. Si rezultat i kësaj klinikat dhe ndërtesat tjera publike që janë duke u ndërtuar nuk ofrojnë mjedis të lirë, pa pengesa.
- Janë të nevojshme standarde për ndërtim dhe përshtatshmëri.
- Mungesa e specialitëve/ekspertëve në fushën e qasjes pa pengesa.
- Mungesa e legjislacionit mbi përshtatshmërinë të bazuar në standardet Evropiane.

Shpesh si arsye e mos sigurimit të ambientit pa pengesa përmenden shpenzimet. Mirëpo, kur qasja kyçet në projektin origjinal, shpenzimet shtesë në përgjithësi nuk kalojnë 0,2% të kostos së përgjithshme.

Qëllimi i politikës, është:

Krijimi i një shoqërie pa pengesa e cila u përshtatet nevojave të ndryshme dhe e cila i mundëson tërë popullatës lëvizje të lirë dhe pa pengesa si dhe qasje në informatat në formën në të cilën ata mund t'i përdorin, p.sh. alfabeti Braile, gjuha e shenjave.

Strategjitë përfshijnë:

- Bashkëpunimin midis sektorëve të ndryshëm në mënyrë që përshtatshmëria të realizohet përmes ministrive dhe departamenteve të tyre;
- Trajnimin e personelit;

¹ Për shembull, shkallët, toaletet e papërshtatshme, ashensorët e papërshtatshëm, trotualet jo të rrafshhtë; gur buzinat e larta, etj.

² Për shembull, dyqanet dhe sportelët bankar, kutitë postale publike; telefonët publik, etj.

³ Për shembull, hyrja në supermarketet më moderne, etj.

⁴ Për shembull, trotualet e ngushta, mungesa e shënimit të parkingjeve të posaçme, mungesa e rrugëve të përshtatshme, etj.

- I gjithë personeli relevant në ministritë dhe në bashkësitë lokale duhet të vijojë kursin mbi qasjen pa pengesa, me qëllim që të njihet me nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Profesionistët të cilët janë të kyçur në ndërtimtari gjithashtu duhet të vijojnë kursin në fjalë.
- Bashkëpunimi midis sektorëve të ndryshëm në zhvillimin e sistemit të komunikimit i cili do të ketë qasje për të gjithë njerëzit me aftësi të kufizuar në të pamur, në të dëgjuar dhe komunikim.
- Vetë-përfaqësimi;
- Për të planifikuar një ambient të përshtatshëm është e nevojshme të njihen llojet e ndryshme të aftësisë së kufizuar. Për këtë arsye e rëndësishme është kyçja sa më herët që është e mundur e personave me aftësi të kufizuar dhe organizatave të tyre në procesin e planifikimit. Njerëzit me aftësi të kufizuar më së miri i njohin problemet që lindin nga mungesa e qasjes pa pengesa.

Me qëllim të arritjes së objektivës politike, rekomandohet:

- Koncepti Evropian mbi përshtatshmërinë të miratohet si normë dhe standard lidhur me përshtatshmërinë.
- Projektimi me qasje pa pengesa i të gjitha ndërtesave që shfrytëzohen nga të gjitha departamentet, përfshirë këtu edhe shqyrtimin e artikullit për mënjanimin e pengesave në të gjitha marrëveshtjet lidhëse.
- Zhvillimi i një spektri të gjerë ekspertize për projektimet e qasjes pa pengesa në nivel qendror, regional dhe lokal.
- Implementimi dhe administrimi efektiv i legjislaturës ekzistuese dhe asaj të re, posaçërisht në nivel të bashkësisë;
- Zhvillimi përkatës dhe efektiv i mekanizmave mbikqyrës, përfshirë këtu organizatat e personave me aftësi të kufizuar (OPAK), posaçërisht në nivel të bashkësisë;
- Të sigurohet se planprogramet dhe doracakët të cilat përqëndrohen në normat dhe standardet mbi përshtatshmërinë, caktohen nga ministria relevante si pjesë e programit/trajnimit profesional të arkitektëve, inxhinierëve dhe planifikuesve të urbanizmit;
- Trajnimi për profesionistë dhe punëtorë;
- Zhvillimi i normave dhe standardeve si dhe i mekanizmave mbikqyrës për sigurimin e qasjes në sferën e turizmit;
- Zhvillimi i teknologjisë përkatëse që lidhet me përshtatshmërinë dhe trajnimin.

Disa çështje që lidhen me përshtatshmërinë mund të shqyrtohen dhe implementohen madje edhe para formulimit dhe miratimit të ligjeve dhe rregullave të cilat i mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. Grupi punues mbi përshtatshmërinë autoriteteve lokale u ka rekomanduar të ndërmarrin menjëherë akcione për të shqyrtuar çështjet në vijim:

- Sigurimi i vend parkimeve për personat me aftësi të kufizuar⁵ në të gjitha parkingjet e bashkësisë;

⁵ Vend-parkimet për personat me aftësi të kufizuar duhet të sigurohen dhe të markohen në mënyrë përkatëse. Vend-parkimet duhet të kanë sipërfaqe të rrafshhtë dhe të fortë me sa më pak pjerrtësi që

- Njerëzit me aftësi të kufizuar duhet të kenë leje për parkim në:
 1. Në zonat⁶ në të cilat parkimi normalisht është i ndaluar, p.sh.: ndërtesat e qeverisë, në vendet për të cilat është e nevojshme leje e veçantë për shkaqe të sigurisë, etj.
 2. Në vendet ku parkimi është i ndaluar dhe konsiderohet si shkelje e rregullave të trafikut;
- Kutiat postale⁷ duhet të vendosen në vende të dukshme dhe të përshtatshme në rrugët ku lëvizin këmbësorët;
- Koshat e mbeturinave duhet të vendosen në pozitë të tillë që të mund të arrihen nga përdoruesit e karrocës dhe nga personat e shkurtër;
- Telefonat publik duhet të jenë të vendosura në atë lartësi në të cilën do të jenë të arritshme për përdoruesit e karrocës, personat e shkurtër dhe njerëzit me dëmtime të të pamurit;
- Të përpilohet dhe t'ju shpërndahet personave me aftësi të kufizuar harta e bashkësisë në të cilën janë të shënuara të gjitha ndërtesat që kanë qasje;
- Të sigurohet që agjencitë/organizatat që adresojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar dhe/ose përfaqësuesit e të cilave janë persona me aftësi të kufizuar përfshihen në planifikimin urbanistik dhe në miratimin e projekt propozimeve për rindërtim⁸.
- Të gjitha ndërtesat dhe infrastruktura në ndërtim dhe rindërtim duhet të jenë plotësisht të përshtatshme.

E.6 Transporti

Ekziston nevoja për përparim të shpejtë në zhvillimin e sistemit të transportit publik i cili do të jetë fleksibël dhe do të jetë i përshtatshëm për të gjithë njerëzit e Kosovës, dhe derisa të arrihet një gjë e tillë, qasja për personat me aftësi të kufizuar duhet zbatuar në mënyrë sistematike dhe kreative. Nëse një gjë e tillë nuk arrihet, njerëzit me aftësi të kufizuar do të vazhdojnë të mbesin "të pa dukshëm" dhe nuk do të mund të japin kontributin e tyre ose të shfrytëzojnë shërbimet komerciale dhe shërbime të tjera që janë në dispozicion për pjesën më të madhe të bashkqytetarëve të tyre.

është e mundur, p.sh. duhet të kenë pjerrtësi minimale e cila është e nevojshme për largimin e ujit. Vend-parkimet janë të pranueshme nëse plotësojnë kriteret në vijim: të kanë gjerësinë minimale prej 3.50 metrave apo të jenë të vendosura menjëherë pranë trotuareve apo vendeve publike të cilat sigurojnë hapësirë për të hyrë dhe për të dalë nga vetura. Vend-parkimet për njerëzit me aftësi të kufizuar duhet të jenë të vendosura sa më afër hyrjes kryesore.

⁶ Komuna lokale personave me aftësi të kufizuar duhet t'ju japë dokument përkatës.

⁷ Në pjesën e përparme dhe në të dy anët e kutive postale të cilat janë të vendosura në murr duhet të ekzistojë hapësirë e lire prej 0.50 m minimum (e matur horizontalisht). Kutia postale duhet të jetë e arritshme nga përdoruesit e karrocës dhe nga personat e shkurtër, dhe hapja nuk duhet të jetë më shumë se 1.30 m mbi nivelin e tokës.

⁸ Sidoqoftë, është e rëndësishme që në lidhje me këtë të kërkohet këshillë nga përfaqësuesit zyrtarë të organizatave të personave me aftësi të kufizuar, me qëllim që të paraqitet një vizion i bashkësisë dhe jo mendim personal. Para projekteve ndërtuese apo projekteve të punëve publike të formës së caktuar, zakonisht përgatitet plani në pajtim me rregullat e aktit ligjor për planifikim hapësinor/urbanistik. Meqenëse është e rëndësishme që qasja e personave me aftësi të kufizuar të sigurohet që në fazat më të hershme të projektit, nga autoritetet lokale duhet kërkuar që në projektet lokale të përfshijnë kërkesat që lidhen me këtë çështje.

Objektiva e politikës është:

Të zhvillojë një sistem të përshtatshëm, të lirë dhe multi-modal të transportit publik i cili do të përmbushë kërkesat e pjesës më të madhe të njerëzve me një kosto të ulët dhe, në të njëjtën kohë të bëjë planifikimin e artikujve me kosto më të lartë të cilët janë esencial për njerëzit me aftësi të kufizuar që kanë nevojë më të madhe për të komunikuar dhe lëvizur.

Strategjitë përfshijnë:

- Ngritjen e vetëdijes mbi çështjen e aftësisë së kufizuar dhe vënien në jetë të komponentës orientuese për industrinë e transportit;
- Proçeset për zhvillimin e sistemeve të transportit publik të përshtatshme për të gjithë ku duhet të përfshihen të gjitha palët.
- Pasi që në proçes e sipër është riparimi i mjeteve të transportit publik dhe integrimi i sërishëm i tyre në sektorin e trafikut, ky është momenti i qëlluar për të bërë përshtatjen e autobusëve, trenave, etj, sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuar me qëllim që shpenzimet të jenë sa më optimale.
- Përvojat nga ekonomitë e vendeve në tranzicion dhe ato të zhvilluara vënë në dukje se janë të nevojshme sisteme të specializuara transporti të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar (të ashtuquajtura, « thërrisni mjetin transportues ») me qëllim të përmirësimit të sistemit bazë. Kjo alternativë duhet të shqyrtohet vetëm pas analizës së hollësishme të aplikimit afatgjatë të alternativës bazë.

E.7 Arsimi

Qasja e çështjes së aftësisë së kufizuar duke u bazuar në sferën e të drejtave të njeriut dhe proçeset zhvillimore ka ndikim të rëndësishëm në mënyrën në të cilën ofrohet arsimi. Mësimdhënësit tentojnë të klasifikojnë personat me aftësi të kufizuar në bazë të aftësisë së kufizuar. Në këtë mënyrë, nxënësit me aftësi të kufizuar janë të vendosur në shkolla ose klasë speciale, ose janë përjashtuar nga çdo mundësi e arsimimit me arsyesim se kanë « kufizim të rëndë të aftësisë ». kjo natyrisht rezulton me analfabetizëm dhe nivel të ulët të kualifikimit, veçanërisht në mesin e të rriturve me aftësi të kufizuar, duke kontribuar në këtë mënyrë shkallës së lartë të papunësisë dhe varfërisë.

Ekzistimi i sistemit paralel të arsimit në Kosovë prej vitit 1991 deri në vitin 1999 reflekton rëndësinë e madhe që i kushtohet arsimit në regjion. Në këtë kontekst është shqetësuese mungesa e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Në mars të vitit 2000, në shkollat speciale për fëmijë me vështirësi në të mësuar, me dëmtime në të pamur dhe në të dëgjuar⁹ ishin përfshirë 445 fëmijë. Është vlerësuar se 80% të fëmijëve me aftësi të kufizuar të moshës shkollore nuk janë të përfshirë në proçesin mësimor. Përvojat nga traumat e luftës dhe zhvendosjet gjithashtu sugjerojnë se në mesin e nxënësve ekzistojnë nivele të larta të nevojave të posaçme. Përqëndrimi në arsimin

⁹ "Arsimi në Kosovë: Nga Krizat në Shërim dhe Transformim" nga Profesor Michael Daxner (Mars, 200) UNMIK, Departamenti për Arsim dhe Shkencë.

përfshirës do të jetë i dobishëm jo vetëm për nxënësit me aftësi të kufizuar por edhe për ata që kanë vështirësi në mësim (përvetësim) dhe pjesëmarrje.

Siç është e njohur, sistemi paralel i arsimit (1990-1998) ka ndikuar dukshëm në të gjithë sektorët e arsimit. Kualiteti i arsimit ka rënë dhe përshtatjen me modelet perëndimore është ndërprerë për më shumë se 10 vite. Si pasojë e situatës së ndryshueshme dhe senzitive pas luftës si dhe për shkak të traditave historike dhe kulturore të arsimit në Kosovë, implementimi i çfarëdo reforme nuk do të jetë e lehtë dhe pa kundërshtime. Lidhur me çështjen e sistemit të arsimit dhe arsimit përfshirës shumica e studimeve ndërkombëtare dhe lokale theksojnë problemet vijuese:

- Përpilimi i politikës dhe planifikimi i strategjisë së arsimit janë në pikat e tyre fillestare.
- Sistemi i arsimit nuk është mirë i rregulluar dhe kryesisht funksionon kundër rregullave ad-hok.
- Numri dhe struktura e popullatës së moshës shkollore ende është e papërcaktuar.
- Si nxënësit poashtu edhe mësimdhënësit kanë përjetuar dhunë dhe kanë qenë dëshmitar të dhunës dhe vdekjes.

Lëvizja ndërkombëtare për arsimin përfshirës mbështetet në deklaratën e Salamankës dhe në Kornizën për veprim të miratuar në konferencën botërore për arsimin special të mbajtur më 1994, e cila deklaron:

"Nxënësit me nevoja të posaçme duhet të kenë qasje në shkollat e rregullta të cilat do të duhej t'ju mundësonin metoda pedagogjike që përqëndrohen në vetë fëmijun dhe të cilat mund t'u përgjigjen nevojave të tyre.

Shkollat e rregullta brenda këtij orientimi përfshirës janë mjeti më efektiv në: luftën kundër qëndrimeve diskriminuese, krijimin e një komuniteti në të cilën fëmijët me aftësi të kufizuar do të ndjeheshin të mirëseardhur, si dhe në krijimin e një shoqërie përfshirëse dhe arsim për të gjithë; përveç kësaj, ato sigurojnë arsimim efektiv për numrin më të madh të fëmijëve dhe përmirësojnë efikasitetin dhe së fundi zvogëlojnë shpenzimet në tërë sistemin arsimor".

Në Kosovë, arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar do të duhej të realizohej pikërisht në kuadër të këtij orientimi përfshirës. Sidoqoftë, arsimi përfshirës nuk ka të bëjë vetëm me ofrimin e arsimit fëmijëve me aftësi të kufizuar por më shumë ka të bëjë me ndryshimin rrënjësor në mënyrën në të cilën vështrojmë shumëllojshmërinë në klasa dhe në mbarë shoqërinë. Arsimit përfshirës përqëndrohet në identifikimin dhe mënjanimin e pengesave në të mësuar (përvetësim) dhe pjesëmarrje. Në vend të përpjekjes për t'i bërë individët më "normal", duhet theksuar përpjekja për krijimin e një ambienti "më normal" për individët. Pengesat për nxënësit me aftësi të kufizuar mund të përfshijnë ndërtesat që pengojnë qasjen e lirë. Sidoqoftë, pengesat janë edhe më të mëdha se kjo dhe përfshijnë programin e papërshtatshëm mësimor, pengesat gjuhësore, pritjet (shpresat) e vogla, qëndrimet negative dhe stereotipet lidhur me aftësinë e kufizuar dhe dallime të tjera. Pengesat në të

mësuar gjithashtu mund të rezultojnë nga faktorët socio-ekonomik siç është varfëria apo përkatësia në klasat e shoqërisë. Sistemi i arsimit përfshirës përqëndrohet në përpjekjet e vazhdueshme në çvendosjen apo mënjanimin e këtyre pengesave për të mundësuar arsimim për të gjithë.

Termi nevoja të veçanta në arsim është një term i gjerë dhe nuk lidhet vetëm me aftësinë e kufizuar. Ky term paraqet çdo përgatitje arsimore që duhet bërë përveç përgatitjes arsimore të rregullt me qëllim që t'i përgjigjet personit të veçantë ose "nevojave të veçanta". Në këtë mënyrë, është e mundur që fëmiju me aftësi të kufizuar të mos ketë nevojë për përgatitje të posaçme arsimore (psh, për fëmijun që ka kufizim të lehtë fizik të aftësisë). Fëmiju që nuk ka kufizim të aftësisë mund të ketë nevojë për arsimim të veçantë (special) (psh, fëmijët që kanë trauma nga lufta).

Gjithashtu është e rëndësishme të bëhet dallimi midis arsimit të rregullt dhe atij përfshirës. Arsimi i rregullt haset në rastet kur fëmiju me aftësi të kufizuar kyçet në klasë të rregullt me pak ose aspak ndryshime të klasës ose të programit mësimor. Fëmiju do t'ia dalë mbanë të përballojë në këtë mjedis vetëm nëse ai ose ajo edhe përkundrejt aftësisë së kufizuar ka patur sukses të arrijë nivelin e duhur të dijes (njohurive). Fëmiju duhet t'i përshtatet sistemit. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuar ose me nevoja të veçanta kryesisht lidhet me të drejtat themelore të njeriut për fëmijun që ai të arsimohet me moshatarët e tij. Që kjo e drejtë t'iu mundësohet të gjithë fëmijëve, shkollat dhe sistemi arsimor duhet të ndryshojnë me qëllim që të bëhen më të përshtatshme. Sistemi duhet t'i përshtatet fëmijut. Psh, do të ishte shumë e vështirë kyçja në arsim të rregullt e fëmijut me dëmtim të rëndë mendor meqenëse ai nuk do të ishte në gjendje të funksionojë në të njëjtin nivel si pjesa tjetër e klasës dhe nuk do të mund t'ia dalë mbanë me programin e rregullt mësimor. Mirëpo do të ishte e mundur fëmiju të kyçej aty ku rezultatat e të mësuarit janë përshtatur nevojave të fëmijut. Kjo do të kërkonte një program fleksibël arsimor si dhe individualizimin e qëllimeve. Ne do të duhej të ndryshonim pritjet tona se do të bëjmë fëmijun "më normal" për të siguruar pjesëmarrjen e tij maksimale në jetën e përditshme.

Fëmijët me aftësi të kufizuar dhe prindërit e tyre kanë shumë pak ose aspak zgjedhje (alternativa) në arrijtjen e arsimit kualitativ. Përvoja ndërkombëtare ka treguar se pengesat me të cilat ballafaqohen fëmijët me aftësi të kufizuar gjatë qasjes së tyre në sistemin e rregullt arsimor mund të mënjanohen vetëm përmes legjisllacionit dhe lobimit aktiv. Ky legjisllacion do të përfshinte njohjen e të drejtave të njeriut të çdo fëmiju të ketë qasje në arsim i cili nuk është diskriminues.

Arsimi, në mënyrë tradicionale, është i përqëndruar në vitet e kaluara në shkollë dhe në shkallë më të vogël në arsimin terciar. Lidhjet me sferën e punës dhe trajnimet kanë qenë të dobëta. Ndryshimet në politikën e arsimit kanë rëndësi të posaçme në fuqizimin ekonomik të personave me aftësi të kufizuar në të ardhmen.

Zhvillimi në fëmijërinë e hershme dhe të mësuarit (përvetësimi) fëmijëve me aftësi të kufizuar u mundëson qasje që në moshën më të re në intervenimin e hershëm dhe mundësitë për shoqërizim.

Objektiva e politikës është:

Lehtësimin e qasjes së barabartë në arsimim dhe zhvillimin e një sistemi të vetëm arsimor i cili do të plotësojë nevojat e të gjithë nxënësve në kuadër të mjedisit përfshirës.

Strategjitë përfshijnë:

- Zhvillimin e një politike të qartë përfshirëse e cila përfshinë të gjitha palët dhe e cila është kuptuar dhe pranuar në nivel shkollor dhe nga mbarë bashësia.
- Zhvillimin në shkollat e rregullta të plan-programit mësimor i cili do të ofronte fleksibilitet, mundësinë e plotësimit dhe përshtatjes në pajtim me nevojat e çdo nxënësi në veçanti, pa marrë parasysh kategorinë të cilës ata duket se i takojnë.
- Vazhdimsinë e mësimdhënësve të përfshirë dhe që do të përfshihen në procesin arsimor dhe përkrahjen e trajnimit të tyre.
- Programet për fuqizimin e prindërve me qëllim të inkurajimit të tyre për të marrë pjesë në vlerësimin dhe sjelljen e vendimeve në lidhje me fëmijët e tyre. Këto programe duhet të ndodhin së bashku me senzibilizimin e profesionistëve mbi nevojat ekzistuese.
- Zhvillimin e teknologjisë përkatëse në edukim dhe trajnim.
- Ofrimin e shërbimeve adekuate në arsimimin për të gjithë nxënësit.
- Qasje më të hershme në arsim për të gjithë nxënësit, e veçanërisht për nxënësit me nevoja të veçanta në arsim.
- Fuqizimin e lidhjeve midis arsimit dhe punës.
- Hulimitme efektive dhe relevante.
- Dekretimin e legjislacionit në kuadër të sistemit të vetëm arsimor përfshirës i cili avancon qasjen jo-diskriminuese në arsim.
- Metoda të përshtatshme për vlerësimin dhe identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar.
- Sistemet e transportit të cilat fëmijëve me aftësi të kufizuar do t'iu mundësonin të arrijnë në institucionet arsimore.

E.8 Punësimi dhe fuqizimi ekonomik

Papunësia dhe mungesa e aktiviteteve ekonomike janë ndër problemet fundamentale të cilat prekin pjesën më të madhe të personave me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre. Gjatë kësaj kohe të rekonstruimit papunësia e cila arrin lartësinë deri në 70% prek tërë shoqërinë e Kosovës. Pa dyshim njerëzit me aftësi të kufizuar përjetojnë shkallën më të lartë të papunësisë. Qëllimi i përbashkët i këtij sektori është integrimi i personave me aftësi të kufizuar në rekonstruimin ekonomik të Kosovës, në mënyrë që të mos krijohet një qasje e veçantë ose e izoluar.

Para së gjithash, personat me aftësi të kufizuar duhet dukshëm të marrin pjesë në atë çka zhvillojnë punëdhënësit dhe ndërmarrjet— ashtu siç kërkon tani administrata e UNMIK-ut në lidhje me pjesëmarrjen sa më të madhe të femrave – për t'u bartur imazhi dhe përvoja se personat me aftësi të kufizuar mund të jenë ekonomikisht produktivë. Për shembull, ne e dimë që personat

me aftësi të kufizuar nuk janë të përfshirë sidomos në punësim, shërbimet civile dhe se vetëm një numër shumë i vogël i udhëheqësve dhe punonjësve dinë nëse ekziston ndonjë politikë për punësimin e personave me aftësi të kufizuar. Së dyti, përvojat nga shtetet tjera kanë treguar që është e domosdoshme dekretimi i legjislacionit i cili është hartuar për të mënjanuar pengesat të cilat shpiejnë në diskriminimin e personave me aftësi të kufizuar në vendet e punës dhe në zhvillimin ekonomik. Kjo, për shembull, duhet të përfshijë programet dhe proceset pozitive të veprimit me qëllim të përkrahjes së shumëllojshmërisë në punësim dhe sigurim. Për shembull, edhe pse me rregulloret e tanishme është siguruar barazpesha etnike dhe ajo gjinore, nuk ekziston ndonjë politikë e posaçme e cila do të mundësonte rekrutimin e drejtë, punësimin dhe avancimin e personave me aftësi të kufizuar në rradhët e shërbimeve civile.

Përveç sektorit formal për punësim, prirja globale, sidomos në ekonomitë në tranzicion dhe ato në zhvillim, është të mundësojë që personat me aftësi të kufizuar gjithashtu të kenë qasje në ndihmë dhe përkrahje në nismën (fillimin) e ndërmarrjeve të veta qoftë përmes iniciativave individuale, kooperative ose iniciativave të OJQ-ve.

Përmirësimi i standardit është gjithashtu i nevojshëm për zhvillimin e kapitalit investues dhe fondeve operuese për zhvillime ekonomike dhe zhvillime të tjera të sektorit të aftësisë së kufizuar. Iniciativat për vetë-prodhim nga organizatat e personave me aftësi të kufizuar (OPAK), përfshirë këtu të ardhurat dhe krijimin e paanshëm, sidomos kur prona e shteteve të mëparshme është privatizuar ose bëhen investime të mëdha nga jashtë, duhet të përkrahen përmes legjislacionit, politikës, finansimit të projekteve inicuese dhe strategjive për zhvillimin e resurseve njerëzore.

Shkathtësitë dhe aftësitë organizative për krijimin e një sistemi efikas të punësimit, zhvillimin e ndërmarrjeve si dhe krijimin e strukturave të cilat do të sjellin të ardhura/pasuri, kërkojnë zhvillimin e aftësive ekonomike në qeveri, OPAK dhe partnerëve nga sektori privat.

Objektiva e politikës është:

Krijimi i kushteve për rritjen e shkallës së punësimit, dhe mundësi të zhvillimit ekonomik për personat me aftësi të kufizuar me qëllim të zvogëlimin të dallimeve të të ardhurave midis personave me aftësi të kufizuar dhe atyre pa kufizim të aftësisë.

Strategjitë përfshijnë :

- Krijimin e mundësive për punësim, realizimin e të ardhurave dhe fuqizimin ekonomik të personave me aftësi të kufizuar, me qëllim të plotësimit të nevojave të ndryshme dhe ofrimin e mundësive reale për zgjedhje ekonomike.
- Ngritja e vetëdijes së personave me aftësi të kufizuar mbi potencialet dhe mundësitë e tyre;

- Bashkëpunimi ndër-sektorial midis departamenteve të qeverisë, OPAK-ve dhe sektorit privat duke u përqëndruar në punësimin dhe ndërmarrësinë private të personave me aftësi të kufizuar.
- Programe të posaçme për personelin që punon në punësim dhe për të gjithë të punësuarit për t'u siguruar se ata do të kuptojnë mundësitë (alternativat) ekzistuese lidhur me punësimin dhe avancimin e personave me aftësi të kufizuar të cilët kërkojnë punë dhe të të punësuarve.
- Dekretimin e legjislacionit I cili përkrah një politikë jodiskriminuese, akcionet pozitive si dhe punësimin e barabartë për nëpunësit me aftësi të kufizuar si në sektorin privat poashtu edhe në atë publik dhe që siguron vlerësimin e drejtë të personave me aftësi të kufizuar.
- Krijimin e programeve përkrahëse për ndërmarrësit me aftësi të kufizuar përmes zhvillimit të personelit të specializuar në kuadër të shërbimeve përkrahëse kryesore të cilat kuptojnë dhe janë sensitive ndaj nevojave të ndërmarrësve me aftësi të kufizuar.
- Avancimi I pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar, përmes caqeve dhe sanksioneve, në zhvillimin e infrastrukturës dhe rekonstruimin industrial (psh, në kompleksin Trepça, si nëpunës dhe si subkontraktues), privatizimin ose komercializimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërore, zhvillimin ekonomik dhe iniciativave të huaja investuese direkte. Sugjerohet që ky avancim të marrë formën e objektivës sasiore siç është psh, pjesëmarrjen deri në 10 % të personave me aftësi të kufizuar në punësim dhe sigurim.
- Përfaqësimi I personave me aftësi të kufizuar në trupat qeveritare dhe në këshille.
- Mundësimi i qasjes së personave me aftësi të kufizuar në iniciativat e arsimimit profesional në Kosovë, sërish përmes sigurimit të pjesëmarrjes minimale prej 10% e studentëve me aftësi të kufizuar.
- Meqenëse zhvillimi I bujqësisë ka rol primar, hulumtimi si personat me aftësi të kufizuar mund të kyçen në bujqësi, përfshirë këtu edhe përpunimin, duhet të përfshihet në zhvillimin e përgjithshëm të bujqësisë.
- Sigurimi I sistemit të përshtatshëm të transportit.
- Krijimin e një baze të të dhënave për statusin e punës dhe atë të aftësive të personave me aftësi të kufizuar.

E.9 Qasja në të mira, objekte dhe shërbime

Ekzistojnë padrejtësi të mëdha lidhur me qasjen në të mira, objekte dhe shërbime të personave me aftësi të kufizuar në krahasim me personat e tjerë. Pjesa më e madhe e personave me aftësi të kufizuar kanë përjetuar ndonjë lloj diskriminimi kur kanë tentuar të qasen në të mira, objekte dhe shërbime. Ofruesit e shërbimeve, shpesh mund të refuzojnë ofrimin e shërbimeve, mund të ofrojnë shërbime më të dobëta ose të pavlefshme për personat me aftësi të kufizuar. Të gjitha këto janë forma të diskriminimit të cilat pamundësojnë personat me aftësi të kufizuar të kenë pjesëmarrje të plotë në ekonomi dhe tregti si një tërësi, si dhe të shfrytëzojnë të mirat, shërbimet dhe objektet.

Objektiva e politikës është:

Personave me aftësi të kufizuar t'u mundësohet qasje e barabartë në të mira, shërbime dhe objekte dhe ofruesit e shërbimeve të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura në mënyrë që të përmbushet ky qëllim.

Strategjitë përfshijnë:

- Miratimin dhe implementimin e legjislacionit dhe rregulloreve për të mbrojtur parimin sipas të cilit është kundër ligjit që personat të cilët ofrojnë shërbime ose artikuj popullatës të diskriminojnë personat me aftësi të kufizuar dhe të sigurohet ligjërisht që personat të cilët ofrojnë shërbime, gjatë ofrimit të të njejtave, ndaj personave me aftësi të kufizuar të sillen njëjtë si ndaj personave të tjerë.
- Publikimin e kodit të punës në të ciën përmbahen këshilla praktike për njerëzit që ofrojnë shërbime në mënyrë që t'u mundësojnë qasje dhe shërbime të pranueshme personave me aftësi të kufizuar.
- Sigurimin që njerëzit me aftësi të kufizuar mund të kërkojnë ndihmë nga ligji kur ata kanë ankesa nga ky lloj diskriminimi me ndihmën e të gjitha shërbimeve në dispozicion, duke përfshirë këtu kontaktet në bashkësinë lokale dhe organizata.
- I gjithë personeli brenda sektorit publik i cili punon në cilindo lloj të ofrimit të shërbimeve publike, strehimit ose sigurimit të të mirave, duhet të kalojë nëpër një trajnim të përshtatshëm për të ofruar qasje të barabartë personave me aftësi të kufizuar.
- Të gjithë ofruesit e shërbimeve të sektorit privat, detyrimisht duhet të bëjnë trajnime të kualifikuara që personave me aftësi të kufizuar t'ju lehtësojnë qasjen në të mira, objekte dhe shërbime.”

E. 10 Pjesëmarrja në jetën e përditshme

Pjesëmarrja në jetën e përditshme është e drejtë themelore e çdo njeriu. Kjo e drejtë ndodhet në nenin 25 të Konventës ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike nga 1994. Megjithatë, në praktikë, personat me aftësi të kufizuar shpesh ballafaqohen me pengesa në ushtrimin e të drejtës së tyre në sferën politike për të marrë pjesë në procesin zgjedhor dhe të drejtën e votimit.

Si e para, vendet e regjistrimit të votuesve dhe qendrat e votimit mund të mos kenë qasje për personat me aftësi të kufizuar. Në anën tjetër, shoqëria mund të konsiderojë që jeta e personave me aftësi të kufizuar nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë ose pjesëmarrja e tyre si kandidat në zgjedhje nuk është e vlefshme (e arsyeshme). Kjo nuk është çështje e mënjanimit vetëm te pengesave fizike por gjithashtu edhe tës botëkuptimeve negative.

Objektiva e politikës është:

Personave me aftësi të kufizuar t'u mundësohet qasje e barabartë dhe mundësi për të luajtur një rol të plotë në procesin zgjedhor dhe në jetën politike.

Strategjitë përfshijnë:

- Miratimin dhe implementimin e legjislacionit dhe rregulloreve kombëtare me të cilat personat me aftësi të kufizuar do të kenë qasje të barabartë dhe mundësi të luajnë një rol të plotë në procesin zgjedhor dhe në jetën politike.
- Miratimin dhe implementimin e standardeve të vlefshme kombëtare të cilat do të rregullonin dhe siguronin qasje të barabartë në shërbimet zgjedhore për votuesit me aftësi të kufizuar, përmes vendeve të regjistrimit të votuesve, vendvotimeve ose ekipeve mobile të cilat do të sigurojnë shërbime elektorale në shtëpi ose në ndonjë vend tjetër të përshtatshëm.
- Verifikimin e udhëzuesve për administrim zgjedhor mbi të gjitha aspektet e qasjes në shërbime, me të cilat do të përkrahen standardet e obligueshme kombëtare.
- Sigurimi i posterëve dhe pajisjes në vendet e regjistrimit dhe në vendvotimet për të mundësuar shtypjen posterëve të fletëvotimeve dhe
- Sigurimi i shembujve të thjeshtë (të qarta) të fletëvotimeve ose ndihmës në vendin e votimit, me qëllim që të ndihmohen personat me dëmtim të pamurit.

E.11 Burimet njerzore dhe zhvillimi i shkathtësive (aftësive)

Parakusht themelor i zhvillimit është kapaciteti i shoqërisë për të shfrytëzuar burimet e qëndrueshmërisë. Mirëpo, shumica e personave me aftësi të kufizuar ndodhen në gjendje të një zhvillimi të pamjaftueshëm si pasojë e diskriminimit në qasje ndaj mundësive ekzistuese në të kaluarën dhe tani. Zhvillimi i burimeve njerzore është njëri nga elementet kyçe i cili mund të shfrytëzohet në pengimin e ciklit të varfërisë dhe zhvillimit të pamjaftueshëm.

Objektiva e politikës është:

Aftësimi i personave me aftësi të kufizuar në pjesëmarrjen efektive në: zhvillimin ekonomik të bashkësisë së tyre dhe shoqërisë në tërësi; qeverisje; dhe në mbikqyrjen e barazimit të mundësive të personave me aftësi të kufizuar brenda bashkësive lokale të tyre, në nivel regjional dhe atë qëndror.

Strategjitë përfshijnë :

- Transformimin e shërbimeve kryesore për trajnim profesional me qëllim të sigurimit të qasjes dhe përfshirjes më të madhe në trajnim të personave me aftësi të kufizuar.
- Zhvillimin e shkathtësive të personave me aftësi të kufizuar përmes thellimit të aftësive të specializuara të tyre në mënyrë që ato të mund të realizojnë të ardhurat e tyre përmes sektorit formal të punësimit, përmes bizneseve të vogla ose projekteve të bashkësisë.
- Sigurimi i programeve për arsimimin themelor të të riturve.
- Krijimi i mundësive për personat me aftësi të kufizuar të fitojnë përvojë pune. Kjo mund të kërkojë përshtatjen e mjedisit dhe sigurimin e pajisjes dhe teknologjisë së specializuar për trajnim dhe vlerësim.

- Zhvillimin e standardeve përkatëse të trajnimit përmes plotësimit të nevojave të veçanta të personave me aftësi të kufizuar të përfshirë në trajnim.
- Përmes veprimit pozitiv, nëpunësit me aftësi të kufizuar duhet të kenë të drejtën e pjesëmarrjes në kurset për avancim, programet trajnuese mbi teknologjitë e reja si dhe trajnimin mbi vendosjen e arsimimit me pagesë në baza të barabarta.
- Zhvillimin e programeve që janë në zbatim dhe atyre që do të zbatohen me qëllim të orientimit dhe trajnimit të instuktorëve profesionistë në lëmitë të cilat janë të lidhura me aftësinë e kufizuar.

E. 12 Mirëqenia sociale

Zyra e punëtorit social është pikë kyçe për qasje në sistemin e ofrimit të shërbimeve për një numër të madh të personave me aftësi të kufizuar. Për fat të keq, natyra e fragmentuar e këtij sistemi, orientimi klinik dhe trajtues i pjesës më të madhe të punëtorëve socialë në trajnim si dhe qëndrimet profesionale shpesh i prijnë mungesës së fuqizimit personal dhe të bashkësisë si dhe referimit efektiv në sektorët e tjerë. Kjo do të thotë që sistemi i mirëqenies sociale duhet të punojë në pajtimin dhe rekonstruimin në nivel të bashkësisë, në fuqizimin në nivel personal dhe atë të bashkësisë si dhe të shqyrtojë pyetjet lidhur me arsimin, punësimin, transportin dhe strehimin lidhur me personat me aftësi të kufizuar.

Ndryshimi i modelit në modelin social dhe të drejtave të njeriut nënkupton që shërbimet e mirëqenies sociale duhet të hartohen me qëllim të lehtësimit të pavarësisë në shoqëri dhe jo sigurimit të varshmërisë nga shërbimet sociale.

Objektiva e politikës është:

Sigurimin e shërbimeve të mirëqenies sociale që kanë për qëllim të integrojnë personat me aftësi të kufizuar në të gjitha aktivitetet në bashkësinë e tyre.

Strategjitë përfshijnë:

- Riorientimin dhe trajnimin e punëtorëve të mirëqenies sociale të cilat do të shpiejnë në restrukturimin e shërbimeve të mirëqenies sociale.
- Zhvillimin e bashkësisë përmes përkrahjes dhe fuqizimit të organizatave të personave me aftësi të kufizuar.
- Zhvillimin e bashkësisë përmes pjesëmarrjes të të gjithë sektorëve të shoqërisë në të gjitha iniciativat për zhvillimin e bashkësisë, p.sh, proceseve integruese për zhvillimin e bashkësisë.
- Zhvillimin e shërbimeve për ndihmë personale me qëllim të aftësisë të drejtojnë jetën e tyre dhe të shfrytëzojnë të drejtën e tyre kur janë në pyetje zgjedhjet dhe dinjiteti brenda shtëpise të tyre.
- Zhvillimin e shërbimeve integrale në bashkësi për personat me kufizim të rëndë të aftësisë të cilat do të sigurojnë një aktivitet të rëndësishëm social dhe ekonomik dhe të cilat do të shpiejnë drejt pavarësisë dhe fuqizimit të tyre. .

- Deinstitutionalizimin e institutive siç është Instituti special në Shtime përmes rivendosjes së kontakteve midis individëve të cilët janë vendosur atje, familjeve të tyre dhe bashkësisë lokale.

E.13 Sigurimi social

Aty ku ekziston struktura e sigurimit social, duhet bërë analiza e sistemit lidhur me atë si të pengohet krijimi i varshmërisë së panevojshme dhe si të avancohet integrimi social dhe pavarësia ekonomike.

Objektiva e politikës është:

Analizimi dhe zhvillimi i sistemeve racionale ekonomike në rrjetin e sigurimit social e cila gjithashtu avancohet integrimin shoqëror dhe pavarësinë ekonomike.

Strategjitë përfshijnë:

- Analizën e sistemit ekzistues, zhvillimin e sistemit të mirëqenies sociale dhe sistemit të penzionit nga ana e Departamentit të punës dhe mirëqenies sociale, duke u përqëndruar sidomos në inkurajimin/dekurajimin e fuqizimit, integrimin dhe punësimit.
- Zhvillimin e pilot-projekteve të cilat demonstronë qasjet alternative në sistemin e sigurimit social, për shembull, avancimin e qasjes në mundësitë për të filluar bizneset e vogla, të cilat balancojnë nevojat për një rrjet të sigurtë si dhe nxitjen e iniciativave ekonomike.
- Implementimin e sistemit alternativ të sigurimit social në gjith sistemin.

E.14 Strehimi

Pjesa më e madhe e personave me aftësi të kufizuar kanë shumë pak shpresë të jetojnë të pavarur. Objektet/shtëpitë, banesat dhe mjediset shpesh nuk janë të përshtatshme si pasojë e projektimit, infrastrukturës joadekuate dhe tejngrarkesës me banorë.

Në planet e objekteve shumë rallë është planifikuar qasja pa pengesa, e cila gjë përjashton personat me aftësi të kufizuar të kenë banesa/shtëpi, të vizitojnë familjarët ose shokët e tyre.

Meqenëse deinstitutionalizimi (p.sh, Instituti special në Shtime) është në proces e sipër, duhet të zhvillohen plane të veçanta lidhur me nevojat e strehimit të cilat do t'i kenë personat me aftësi të kufizuar kur do t'i braktisin institucionet në të cilat ndodhen për momentin.

Objektiva e politikës është:

Personave me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre t'u sigurohet strehim i sigurtë dhe i përshtatshëm në objektet e banimit përmes qasjes së drejtë në një varg mundësishë.

Strategjitë përfshijnë:

- Objekte të përshtatshme banimit, përsëri me 10% të kapacitetit të planifikuar.
- Pronësia mbi shtëpitë të përshtatshme, përsëri me 10% të kapaciteteve.
- Sigurimi i mundësive të ndryshme lidhur me strehimin, duke përfshirë banimin me familjen/farefisën, në shtëpitë e përbashkëta ose vetëm.

E.16 Aktivitetet kulturore dhe krijuese, sporti dhe rinia

Personat me aftësi të kufizuar kanë nevoja të njëjta për aktivitete kulturore dhe ato krijuese, sport dhe rekreacion sikur edhe të tjerët. Sporti dhe aktivitetet krijuese në përgjithësi konsiderohen si komponentë kyçe në integrimin e personave me aftësi të kufizuar në shoqëri. Sporti shpesh është një komponentë jetike e rehabilitimit dhe përfshirjes së suksesshme të personave me aftësi të kufizuar. Aktivitetet krijuese dhe kulturore krijojnë mundësinë për vetë-shprehje si dhe mundësojnë normalizimin dhe stabilizimin e ndjenjave duke ofruar zbatimje dhe stimulim, duke lehtësuar (zbutur) mërzinë dhe në disa raste duke ndihmuar në tejkalimin e traumës.

Sporti dhe aktivitetet kulturore në nivel shkollor janë kyçe për zhvillimin e kualiteteve fizike si dhe për zhvillimin e vetë-respektit, vetë-shprehjes, guximit (kurajos) dhe durimit. Për këtë arsye është e domosdoshme që sporti në nivel shkollor urgjentisht të fitojë një vëmendje të veçantë.

Objektiva e politikës është:

Të zhvillojë dhe zgjërojë aktivitetet sportive dhe ato kulturore për personat me aftësi të kufizuar në mënyrë që ato të marrin pjesë në sport edhe me qëllim të rekreimit edhe atë garues.

Strategjitë përfshijnë:

- Ndërtimin e aftësive trajnuese të trainerëve /instructorëve të cilët kanë njohuri nga sporti, arti dhe kultura për personat me aftësi të kufizuar.
- Krijimin e objekteve kulturore dhe sportive me qasje.
- Programe arsimore me të cilat do të vetëdijësonin publikun, personat me aftësi të kufizuar (sidomos ata që jetojnë në zona rurale), sponsoruesit si dhe administruesve të sportit dhe kulturës mbi format e ndryshme të aktiviteteve sportive dhe kulturore për personat me aftësi të kufizuar.
- Sporti për personat me aftësi të kufizuar duhet të jetë sa më i kyçur në rrjedhat kryesore sportive me qëllim të rritjes së arsyeshmërisë së sponsorizimit. Me fjalë të tjera, duhet të promovohet së bashku me ngjarjet e tjera sportive.
- Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në aktivitete me qëllim të shfrytëzimit të potencialeve krijuese të individit.

E.17 Statistikat

Është e rëndësishme që grumbullimi i të gjitha të dhënave, studimi dhe shpërndarja e informatave reflekton faktin që aftësia e kufizuar - klasifikimi, definimi dhe përmasat e tij – domosdoshmërisht përfshijnë aspektet

biomjeksore, sociale, ekonomike dhe politike. Për këtë arsye, personat me aftësi të kufizuar duhet të jenë pjesë përbërëse e procesit studimor dhe e grumbullimit të të dhënave.

Qeveria, OJQ-të/OPP-të dhe sektori privat që të mund të bëjnë planifikimin dhe drejtimin e mjeteve të tyre atje ku janë më të nevojshme, kanë nevojë për informacione të ndryshme mbi aftësinë e kufizuar.

Personat me aftësi të kufizuar duhet të kenë qasje në të gjitha informacionet mbi shëndetin, arsimin dhe aspektet sociale të cilat ndikojnë në jetën e tyre. Të gjithë strategjitë dhe mekanizmat të cilat zhvillohen me qëllim që të bëjnë informacionet sa më të përshtatshme për qytetarët, duhet të jenë në formë të tillë që të jenë të përshtatshme edhe për personat me aftësi të kufizuar.

Objektiva e politikës është:

Të zhvillojë dhe të mbajë një sistem informimi i cili do të bazohet në modelin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave sociale për personat me aftësi të kufizuar.

Strategjitë përfshijnë:

- Grumbullimin e të dhënave në lidhje me regjistrimin kombëtar dhe studimet mbi ekonominë shtëpiake, të cilat do të zhvillohen, midis tjerash, në bashkëpunim të ngushtë me universitetet, institutet kërkimore dhe OOP-të. Bashkërendim më të mirë të studimeve të fokusuara në sferën e aftësisë së kufizuar të cilat hulumtojnë hendeqet midis gjendjeve fizike ose mendore të njerëzve dhe burimeve/kapaciteteve të tyre (personale, ekonomike, sociale) dhe mjedisit (gjeografik, arkitekturor, social dhe politik) në të cilën jetojnë, punojnë dhe lëvizin.
- Zhvillimin e bazës së të dhënave e cila do të ofronte të dhëna mbi shkaktarët mjekësorë të aftësisë së kufizuar, shërbimet, studimet ekzistuese, nevojat e personave me aftësi të kufizuar dhe incidenca e dëmtimit.
- Avancimin e qasjes së personave me aftësi të kufizuar në të gjitha informacionet të cilat ndikojnë në jetën e tyre.

F. LEGJISLACIONI DHE POLITIKA

Legjislacioni, nëse drejtohet ashtu siç duhet, mund të shfrytëzohet për avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Megjithatë, dekretimi i ligjit mund të jetë i pamjaftueshëm për të siguruar realizimin e këtyre të drejtave. Prandaj është e nevojshme të krijohen institucione dhe mekanizma për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Megjithatë, legjislacioni paraqet një pikë të rëndësishme udhëzuese dhe ofron një përkrahje të fortë.

F.1 Objektivat e politikës

Legjislacioni, qoftë kur është pjesë e një legjislacioni tjetër ose ekziston vetë si i tillë, duhet të bazohet në parimet e përshkruara në kornizën Kushtetuese. Personave me aftësi të kufizuar ai duhet t'u sigurojë barazi, mosdiskriminim dhe mbrojtje. Legjislacioni ekzistues duhet të jetë në pajtim me parimet e kornizës kushtetuese.

Zhvillimi i legjislacionit antidiskriminues duhet të ketë qasje të dyfishtë. Së pari ai duhet të kërkojë mënyrën për zgjidhjen e pabarazisë nga e kaluara përmes barazimit të mundësive krahas kontrollimit të njëkohshëm të çdo përpjekjeje e cila shpion drejt vazhdimin të diskriminimit. Në të njëjtën kohë, ajo duhet të mbrojë parimet e kornizës Kushtetuese dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare në ruajtjen e të drejtave të njeriut.

F. 2 Strategjitë

Të gjithë legjislacionet duhet të përshtaten në kontekstin e qëllimeve politike në pajtim me interesin e sektorit të aftësisë së kufizuar.

Në këtë mënyrë:

Duhet të përfshijë sektorin e aftësisë së kufizuar në diskutimin rreth legjislacionit të propozuar.

Duhet të kërkojë bashkëpunimin ndërsektorial midis të gjitha palëve të kyçura nga sektori privat dhe ai publik.

G. IMPLEMENTIMI

Që të sigurohet bashkrëndimi dhe implementimi i kornizës gjithpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në politikën e qeverisë, rekomandohet ekzistimi i Zyrës mbi çështjen e personave me aftësi të kufizuar brenda strukturave qeveritare, e cila do të jetë e vendosur në nivel të zyrës së Kryeministrit. Qëllimi i ekzistimit të zyrës në nivel të zyrës së Kryeministrit është të sigurojë qasjen e duhur në të gjitha departamentet e qeverisë dhe të sigurojë ndikim pozitiv në të gjitha legjislacionet, programet dhe politikat e qeverisë.

Përveç kësaj, grupi punues ekzistues i UNMIK-ut mbi çështjen e aftësisë së kufizuar do të transformohet në Këshill mbi çështjen e aftësisë së kufizuar si strukturë e përhershme konsultative e qeverisë, e përkrahur nga dhe që punon ngushtë me Zyrën mbi çështjen e aftësisë së kufizuar.

Funksionet e Zyrës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar do të jenë:

- Të lehtësojë, bashkërendojë dhe mbikqyrë implementimin e kornizës gjithpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar ;
- Të sigurojë lidhjen midis Qeverisë dhe shoqërisë civile përmes Këshillit mbi çështjen e aftësisë së kufizuar.

- Të zhvillojë sistemin menaxhues për bashkrendimin e planifikimit, implementimit dhe mbikqyrjen lidhur me çështjen e aftësisë së kufizuar në ministri të ndryshme.
- Të jetë Sekretariat për Këshillin mbi çështjen e aftësisë së kufizuar.
- Të sigurojë këshilla Zyrës së Kryeministrit mbi çështjen e aftësisë së kufizuar;
- Të sigurojë arsimim të gjerë publik dhe ngritjen e kapacitetit të lëvizjes së aftësisë së kufizuar dhe të institucioneve qeveritare në implementimin e kornizës gjithpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar ;
- Të përkrahë zhvillimin e legjisllacionit;
- Të përkrahë dhe bashkrendojë programet për vetëdijësim publik me qëllim që të ndryshojë paragjykimet fundamentale të shoqërisë;
- Të përkrahë analizat e buxhetit me qëllim të identifikimit nëse burimet janë drejtuar në masë të duhur në sferën e aftësisë së kufizuar e sidomos në integrimin dhe fuqizimin e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të sigurojë mjete financiare përmes të cilave do të përkrahet implementimi i kornizës gjithpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar ;

Me qëllim që të kuptohen strategjitë që janë përfshirë në këtë dokument, është e nevojshme që komunat të zhvillojnë një plan implementimi në nivel lokal.

H. MBIKQYRJA (monitorimi)

Mbikqyrja është një element thelbësor në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Mbikqyrja mund të shfrytëzohet si mjet korrektues i të drejtave të shkelura të personave me aftësi të kufizuar. Gjithashtu mund të shfrytëzohet për të matur tendencat dhe format e diskriminimit.

Edhe pse të gjitha strukturat mbikqyrëse në Kosovë duhet të mbikqyrin të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, Zyra mbi çështjen e aftësisë së kufizuar dhe Këshilli mbi çështjen e aftësisë së kufizuar do të kenë përgjegjësi të veçantë në këtë detyrë.

Zyra mbi çështjen e aftësisë së kufizuar, meqenëse ndodhet në lokacionin qëndror të Qeverisë dhe meqenëse mban përgjegjësinë për bashkrendimin e implementimit të kornizës gjithpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar, do të jetë një strukturë kyçe në qeveri në mbikqyrjen jo vetëm të procesit implementues të saj por gjithashtu edhe në ndikimin që ka ai si dhe në mbikqyrjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në përgjithësi.

Këshilli mbi çështjen e aftësisë së kufizuar, në të cilin marrin pjesë shoqëria civile si dhe departamentet e qeverisë, gjithashtu do të kenë një rol të rëndësishëm mbikqyrës.

Përfundimisht, siç është edhe rasti në praktikën ndërkombëtare, lëvizja për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë në formën e Handikos-it, gjithmonë do të marrë përsipër rolin e mbikqyrjes, si zë i personave me aftësi të kufizuar në Kosovë.

SHTOJCA 1

**TERMINOLOGJIA SHQIP-ANGLISHT MBI
DËMTIMET, AFTËSINË E KUFIZUAR DHE
PENGESAT NË PJESËMARRJE**

1 Terminologjia e parapëlqyer

Gjuha është mjet i fuqishëm dhe terminologjia mund të ndikojë në etiketimin e personave me dëmtime, duke krijuar stereotipe, duke diskriminuar dhe përfundimisht duke krijuar një kulturë të mospranimit të shumëllojshmërisë. Duhet shmangur fjalët që lidhen me stereotipet negative ose që janë krijuar për të ngjallur mëshirë (keqardhje). Dëmtimi i personit mund të përmendet vetëm nëse kjo është e domosdoshme. E rëndësishme është se terminologjia pasqyron një ndryshim të caktuar në filozofi ndryshe nga qasja e tanishme mjekësore/individuale ndaj çështjes së aftësisë së kufizuar. Ja disa shembuj të terminologjisë së parapëlqyer:

- Përdorni termin *dëmtim* dhe jo *hendikep*. Fjala *hendikep* rrjedh nga shprehja *cap in hand* (kapela në dorë), që paraqet lypësin dhe që nga shumica e njerëzve me dëmtime është e padurueshme. Termet e tjera që duhet shmangur janë: *e metë, gjymtim fizik/ mendor*.
- Edhe pse disa persona me dëmtime parapëlqejnë termat me të *meta fizike* ose *i aftë në një mënyrë tjetër*, këto terma nuk duhet përdorur..
- Shmangni shprehjet *vuan nga, i prekur nga apo viktimë e*, të cilat, që të gjitha, dëmtimin e cilësojnë si negative. Termi *vuan nga* shpreh një dhembje të vazhdueshme dhe mundim, gjë që nuk vlen për shumicën e njerëzve me dëmtime, ashtu si për njerëzit që nuk kanë dëmtime. *I prekur nga* tregon sëmundje, çka shumica e aftësive të kufizuara nuk janë. *Viktimë e*, nënkupton krimin që është bërë mbi personin i cili ka aftësi të kufizuara.
- Mos i përdorni shprehjet *i lidhur për karrocë* apo *i burgosur në karrocë*. Këta njerëz i shohin karrocet e tyre si mënyrë e përshtatshme të bartjes, jo burgje, dhe shprehja “i lidhur/i burgosur” kundërshtohet nga fakti që shumë njerëz me aftësi të kufizuara motorike angazhohen në aktivitete të ndryshme pa karrocet e tyre duke përfshirë këtu vozitjen dhe gjumin. Shprehja e përshtatshme është *përdor karrocë*.
- Përdorni termat *i/e shëndetshëm* apo *person pa dëmtim*. Termat *normal* dhe *i tërë* janë të papërshtatshme dhe të pasakta.
- Shumica e aftësive të kufizuara nuk janë sëmundje. Mos e quani “pacient” personin me dëmtim, përveç nëse është fjala për shtrimin e tij në spital. Në kontekstin profesional dhe të terapisë mjekësore parapëlqehet termi *klient* ose *vizitues*.

Njerëzit që veten e tyre e konsiderojnë pjesë të kulturës së të shurdhërve, vetëvetes i referohen si të *Shurdhër* me shkronjë Sh të madhe. Asnjëherë mos i përdorni termat *shurdh-memec* apo *i shurdhër dhe memec*. Njerëzit e shurdhër nuk janë memecë, ata komunikojnë me gjuhën e shenjave.

- Shmangni termet *i deformuar, deformim dhe defekt i lindur*. Një person mund të jetë i lindur pa duar apo të ketë një dëmtim kongjenital (të lindur), por mund të mos jetë defektoz.
- Përdorni terminologjinë ku njerëzit do të jenë në vend të parë. Në këtë mënyrë flasim për *person me sindromë të Daun-it*. Kjo vë më shumë theksin në personin se në dëmtimin (mangësinë) e tij. Shmangni termet *mongol ose mongoloid*.
- Shmangni termert *mentalisht i retarduar, i çmendur, i krisur, përvetëson ngadalë dhe me dëmtim të trurit*. Përdorni: person me dëmtim intelektualë ose person me probleme emocionale.

2.Termet e përgjithshme

Përshtatshmëri (accessibility) – paraqet pengesat e mjedisit të cilat përjashtojnë njerëzit nga pjesëmarrja. Pengesat ndikojnë në një numër të madh njerëzish dhe jo vetëm në ata që kanë dëmtime të dukshme. Personat e moshuar, gratë shtatzënë, nënat me foshnje në karrocë dhe personat me sëmundje kronike për çdo ditë hasin në pengesa të njëjta arkitektonike sikurse edhe personat të cilët përdorin paterica dhe karrocë. Përshtatshmëria gjithashtu i referohet qasjes në fjalët e shkruara dhe të folura për personat me dëmtim të të dëgjuarit dhe të folurit dhe për ata që janë analfabet.

Mjete ndihmëse (assistive devices) – mjete të cilat përdoren nga persona me dëmtime fizike ose dëmtime sensoriale me qëllim të tejkalimit të pengesave të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e zakonshme.

Pengesa në pjesmarrje (barriers to participation) – këto janë pengesa të cilat pengojnë personat me dëmtime nga pjesëmarrja e plotë në shoqëri. Ato përfshijnë:

- paragjykimet (attitude barriers) – (p.sh, stereotipet e personave me dëmtime si persona të varur dhe që kanë nevojë për kujdes),
- pengesa fizike (physical barriers) – siç janë pengesat arkitektonike p.sh, projektimi i ndërtesave, infrastruktura urbane dhe rurale e cila përjashton përdoruesit e karrocës, personat e moshuar, prindërit të cilët shtyejnë karrocën e foshnjës etj.
- Pengesa në komunikim (communication barriers) – të cilat përjashtojnë personat me dëmtime nga qasja e barabartë në informata në krahasim me personat të cilët nuk kanë dëmtime. Për shembull, mungesa e alfabetit të Brail-it dhe gjuhës së shenjave do të përjashtojë nga pjesëmarrja personat me dëmtim të të pamurit dhe të dëgjuarit.

Aftësi e kufizuar (disability) – konsiderohet si një formë e shtypjes dhe paraqet pengesat ose kufizimet e aktiviteteve të cilat i ka shkaktuar organizimi

bashkëkohor i shoqërisë, e cila merr shumë pak ose nuk merr aspak në konsideratë personat të cilët kanë dëmtime fizike ose dëmtime të tjera dhe në këtë mënyrë përjashton ata nga aktivitetet kryesore të shoqërisë (Davis 1996; Abberly 1996).

Ndërhyrje e hershme (early intervention) – marrëdhënia midis familjes dhe ofruesve të shërbimeve me qëllim të zhvillimit maksimal të fëmijëve me aftësi të kufizuar nga lindja deri në moshën 3 vjeç.

Përshtatshmëri e mjedisit (environmental accessibility) – përfshin përshtatshmërinë e mjedisit me ndërtesa dhe përshtatshmërinë në kuptim të qasjes në informacione/komunikim. Në aspektin e planifikimit të politikës përshtatshmëria nënkupton masat e ndërmarra me qëllim të sigurimit të një mjedisi të lirë, pa pengesa.

Identifikimi (identification) – grumbullimi i informatave për personin përmes vrojtimit, intervistimit dhe analizës formale për të vendosur nëse personi ka dëmtim.

Dëmtimi (impairment) – është përshkrim objektiv i cili definon cilëndo humbje në kuptim të strukturës ose funksionit psikologjik ose atij fiziologjik, siç është humbja e të dëgjuarit, dëmtimi i palcës kurrizore ose dëmtimi i trurit.

Përfshirja (inclusion) – sistem vlerësues sipas të cilit të gjithë individët, pavarësisht nga aftësia kufizuar, kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitetet rekreative, profesionale, sociale dhe ato arsimore të bashkësisë së tyre së bashku me bashkëmoshatarët e tyre. Kjo është filozofi e cila kërkon të distancohet nga ofrimi i shërbimeve të veçuara për personat me dëmtime dhe e cila përpiqet të sigurojë përkrahje individëve në pjesëmarrjen e plotë të tyre në bashkësi.

Arsimi përfshirës (inclusive education) – është ofrimi i arsimit brenda sistemit vlerësues përfshirës. Ai flet për:

- Njohjen (pranimin) se të gjithë fëmijët dhe të rinjtë mund të mësojnë dhe se të gjithë ata kanë nevojë për përkrahje.
- Dhënien e mundësisë strukturave arsimore, sistemeve dhe metodave mësimore të plotësojnë nevojat e të gjithë nxënësve/studentëve.
- Respektimin e dallimeve midis nxënësve/studentëve, pa marrë parasysh moshën, gjininë, përkatësinë etnike, gjuhën, klasën, dëmtimin, statusin e HIV-it etj.
- Ndryshimin e qëndrimeve, sjelljes, metodologjisë, plan-programit dhe mjedisit me qëllim të plotësimin të nevojave të të gjithë nxënësve/studentëve.
- Maksimizimin e pjesëmarrjes së të gjithë nxënësve/studentëve në kulturën dhe në plan-programin e instituteve arsimore dhe minimizimin e pengesave në të mësuar.

Plani i arsimit individual (individual education plan) – plan i shkruar për programin e arsimit individual të nxënësit/studentit, i cili i përshtatet

nevojave unike të tij/saj në të mësuar (përvetësim). Ai cilëson qëllimet dhe procedurat përkatëse të nxënësit/studentit me nevoja të veçanta përmes konsultimit të prindërve dhe mësimeve të tyre.

Shkollë e rregullt (regular school) – shkolla e bashkësisë e cila ofron arsimin e fëmijëve që i takojnë asaj bashkësie.

Segregim-i, veçim-i (segregation) – ndarja e një grupi njerëzish nga pjesa tjetër e bashkësisë, sidomos për shkak të dëmtimeve të tyre dhe trajtimi i ndryshëm i tyre.

Edukim special, i veçantë (special education) – hartimi i procesit arsimor për të plotësuar nevojat individuale në të mësuar (përvetësim) dhe ato zhvillimore të nxënësit. Është shërbim dhe jo vend dhe mund të ofrohet në mjedise të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe shkollat e rregullta dhe ato speciale.

Nevoja të veçanta, speciale (special needs) – nevojat që mund t'i ketë një individ të cilat duhet plotësuar me qëllim që personi të jetë në gjendje të ketë pjesëmarrje të plotë në jetën e bashkësisë.

Shkollë speciale (special school) – shkollë e projektuar për nxënës/studentë me dëmtime.

3. Dëmtimet (impairments)

3.1 Dëmtimet fizike (physical impairments)

Dëmtimet fizike u referohen dëmtimeve kongjenitale (të lindura) ose të fituara të muskujve, nervave, kockave ose lëkurës, të cilat i prijnë pakësimit të lëvizshmërisë ose vështirësive në kryerjen e aktiviteteve ditore siç janë: lëvizja, kujdesi personal, veshmbathja, të ushqyerit, pastrimi, etj. Mund të shoqërohet me dobësi të përgjithshme, dhembje, rritjen e tonusit dhe spasticitet.

Mjetet ndihmëse për personat me dëmtime fizike

- **ortozë** (orthosis) – pajisje ndihmëse e cila mund të vendoset në trup ose përreth trupit gjatë kujdesit/ trajtimit të dëmtimit fizik
- **protezë dhe gjymtyrë artificiale** (prosthetics and artificial limbs) – Zëvendësim artificial i pjesës që mungon.
- **Longetë, gështallë** (splints) – mjet i cili përdoret për të mbështetur ose imobilizuar një pjesë derisa të shërohet ose të përmirësojë ose pengojë deformimin.
- **Këpucë ortopedike** (orthopedic shoes)
- **Karrocë elektrike** (electric wheelchair)
- **Karrocë dore, e rëndomtë** (manual wheelchair)
- **Karrige tualeti** (toiletchair)

- **Jastëkë për pozitë të mirë gjatë qëndrimit ulur** (cushions for a good sitting position)
- **Shkop për ecje** (walking stick)
- **Mjete të veçanta për të shkruar/ në kuzhinë / kujdes personal si lapsa të trashë, rubinet me dorezë të gjatë, etj.** (special tools for writing/in kitchen/personal care like thick pencils, long handle on the watertap, etc.)
- **Respirator** (respirator)
- **Shëtitore, kornizë për ecje** (walking frame)
- **Paterica, kukëza** (crutches)
- **Përshtatja e automjeteve** (adjustments to vehicles) – mekanizma të veçantë, të cilat bëjnë të mundur qasjen dhe përdorimin e veturave dhe transportit publik për personat me dëmtime/pengesa.
- **Shteg i pjerrët, pjerrinë** (a ramp) – pjerrësi e cila bashkon dy pjesë të ndërtesës, kur njëra prej tyre është më e lartë se tjetra. Shtegjet e pjerrëta janë të nevojshme për të bërë ndërtesat të përshtatshme për personin i cili përdor karrocë.

3.2 Dëmtimet e të pamurit

Visual impairment

Humbja e të pamurit mund të jetë e pjesëshme ose e plotë. *I/e verbër* i referohet humbjes së plotë të të pamurit. Personat e verbër mund të kenë vështirësi në lëvizje dhe në gjetjen e gjërave, në kryerjen e aktiviteteve ditore, shkrim, lexim dhe ndjekjen e shenjave ose komandave vizuale.

Dëmtim i rëndë i të pamurit, të pamur i dobët ose me dëmtim të të pamurit vlejnë më shumë për personat të cilët kanë të ruajtur një shkallë të caktuar të të pamurit, por të cilët kanë të kufizuar të pamurit dhe fokusimin që nuk mund të korrigjohet lehtë me syza. Zakonisht kërkohen syza shumë të specializuara, alfabeti i brail-it ose shkronja të mëdha dhe pajisje të tjera të cilat mund t'ju ndihmojnë të kompenzojnë të pamurit e dobët të tyre.

Mjete ndihmëse për personat me dëmtim të të pamurit

- Alfabeti i **Braille**-it (braille alphabet) – sistem leximi i cili përdor pika të ngritura të cilat paraqesin shkronja ose numra.
- **Mjete shkrimi braille** (braille writing tools)
- **Qen udhëheqës** (guide dog) – qen i trajnuar për të ndihmuar personin në lëvizje
- **Xham zmadhues, llupë** (magnifying glass)
- **Pajisje zmadhuese për lexim** (magnifying reading equipment) – pajisje optike që zmadhon tekstin e shkruar në ekran.

- **Kompjuterë të specializuar** (specialised computers) – p.sh, kompjuter i cili përkthen tekstin e shkruar në braille dhe anasjelltas, i cili jep informacione me zë personit që shkruan (kompjuter folës)
- **Libër folës/audiokasetë** (talking book) – kasetë që mund ta dëgjojë personi me dëmtim të pamurit.
- **Shkopi i bardhë** (white cane) – mjet për lëvizje

Nihmës personal (personal assistant) – person i cili i ndihmon personit me dëmtim në aktivitetet ditore dhe/ose në mësim dhe në punë.

3.2.3 Dëmtimet e të dëgjuarit

Hearing impairment

I/ e shurdhër (deaf) – humbje e plotë e të dëgjuarit. Person i cili është lindur i shurdhër përdor gjuhën e shenjave si gjuhë amtare. Disa persona të shurdhër gjithashtu mësojnë të flasin dhe të lexojnë të folurit përmes vrojtimit të fytyrës së folësit. Ata gjithashtu mësojnë të lexojnë dhe shkruajnë gjuhën e bashkësisë që dëgjon.

Person i shurdhuar (deafned person) – person i cili ka humbur plotësisht aftësinë e të dëgjuarit pasi ka mësuar të flasë. Personi është në gjendje të flasë.

Dëmtim i të dëgjuarit (hearing impairment), **humbje e të dëgjuarit** (hearing loss) – terme të cilat i referohen të gjitha shkallëve të humbjes së dëgjimit, nga ato më të lehta deri te ato më të rënda.

Gjuha e shenjave (sign language) – gjuha e duarve dhe trupit e cila përdoret nga persona plotësisht të shurdhër për të komunikuar me të tjerët. Është gjuha të cilën personat e shurdhër e pranojnë si gjuhë amtare.

Mjetet ndihmëse për personat me dëmtime të të dëgjuarit

- **Dritë sinjalizuese** (flashing light) – funksionon njëjtë sikurse zilja në derë, tregon nëse dikush është te dera.
- **Mjet ndihmës (ndihmesë) për dëgjim** (hearing aid) – aparat, i cili zakonisht është elektronik, shërben për të përforcuar zërin para se ai të arrijë në veshin e brendshëm. Aparati për dëgjim mund t'u ndihmojë personave me vështirësi në të dëgjuar të komunikojnë **më lehtë** me njerëzit që dëgjojnë.

Interpretues (interpreter) – është person që ndihmon në tejkalimin e pengesave në komunikim midis bashkësisë së shurdhër dhe njerëzve që dëgjojnë përmes përkthimit të gjuhës së shenjave në gjuhën e folur dhe anasjelltas.

3.2.4 Dëmtimet intelektuale

Intellectual impairment

Dëmtimet intelektuale i referohen aftësisë intelektuale dhe shkathtësive për vetë-ndihmë - të cilat janë dukshëm nën nivelin e pritur në lidhje me moshën e individit. Dëmtimi manifestohet para moshës 18 vjeçare dhe ka të ngjarë të vazhdojë gjatë tërë jetës. Varësisht nga shkalla e dëmtimit intelektual, vështirësitë shfaqen në tre apo më shumë fusha, duke përfshirë: kujdesin për veten, të kuptuarit dhe të shprehurit e gjuhës, të mësuarit, lëvizjet, orientimin personal, aftësinë për jetë të pavarur dhe mbarëvajtje ekonomike, si dhe nevoja e vazhdueshme për ndihmë personale.

Testet e intelegjencës (T.I.) dhe testet e aftësisë intelektuale përdoren për të caktuar nivelin e aftësisë intelektuale të individit në krahasim me përfaqësuesit e zgjedhur nga e tërë popullata. Testet e intelegjencës (T.I.) mund t'i nënshtrohen paragjytimeve dhe të ofrojnë vetëm një vizion të kufizuar të aftësive të individit. Testimet e tilla duhet bërë nga një psikolog i cili merr në konsideratë paragjykimet ose sjelljet të cilat mund të ndikojnë në rezultat. Që të caktohet niveli intelektual i individit dhe veçanërisht fuqia dhe potenciali i të mësuarit në lëmi të ndryshme, përveç testeve të intelegjencës (T.I.) dhe intervistimit janë të nevojshme edhe testime dhe informacione të tjera. Vlerësimi i fëmiut gjithashtu bazohet në informatat e dikujt që njeh mirë individin, siç janë prindërit e tij/saj. Vlerësimi i personit me dëmtime të aftësisë intelektuale nuk duhet të bëhet vetëm me qëllim të klasifikimit. Ai duhet të shfrytëzohet si mekanizëm i identifikimit të intervenimeve përkatëse të cilat mund të avancojnë aftësinë e individit me dëmtime intelektuale për të mësuar dhe për të marrë pjesë në jetën e bashkësisë.

Shkathtësitë funksionale (functional skills) – shkathtësitë të cilat personit me dëmtim intelektual i mundësojnë të jetojë me një shkallë të caktuar të pavarësisë në bashkësi, p.sh. njohja e shenjave, shkrimi i emrit, plotësimi i formularëve të thjeshtë, shfrytëzimi i të hollave, leximi i kohës.

Intelegjenca, T.I (intelligence, I.Q.) – testet e intelegjencës (T.I.) dhe testet e aftësisë intelektuale shfrytëzohen për të caktuar nivelin e aftësisë intelektuale të individit duke e krahasuar me përfaqësuesit e zgjedhur nga e gjithë popullata. Testet e I nuk paraqesin potencialin e të mësuarit (përvetësimit) të personit. Testet e intelegjencës janë shumë të kufizuara meqenëse injorojnë një sërë aftësishë siç janë kreativiteti, shkathtësitë ndërpersonale, këmbëngulja, etj.

Zhvillim i vonuar (delayed development) – personi me dëmtim intelektual zhvillimin e vonuar e shfaq në shumë procese zhvillimore si (në të folur,

motorikë, zhvillim emocional, fizik dhe atë intelektual). Sidoqoftë, zhvillimi vazhdon gjatë gjithë jetës dhe shumë individë me dëmtim intelektual arrijnë nivele të tilla të zhvillimit për të cilat është menduar se janë të paarrtshme.

Vështirësi në kujtesë (memory difficulties) – individët me dëmtim intelektual kanë vështirësi të shumta të kujtojnë informacione faktike. Kujtesa e tyre për ngjarjet në jetë ose kujtesa epizodike është shumë e fuqishme.

Nevojat e veçanta për personat me dëmtim intelektual

Të drejtat e njeriut (human rights) - individëve me dëmtim intelektual u janë cënuar të drejtat e njeriut në shumë aspekte. Kontrolli mbi jetën e tyre seksuale, finansimit dhe vendime të tjera të rëndësishme në jetë janë kompromituar përmes stereotipeve të paaftësisë së plotë. Ata duhet përkrahur në bërjen e zgjedhjes dhe në kontrollimin e jetës të tyre brenda kontekstit të të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët.

Ndihma në klasë (classroom aid) – fëmiju me dëmtim intelektual mund të kenë nevojë për përkrahje përmes ndihmës në klasë nga ana e mësimitdhënësit në sistemin arsimor përfshirës.

Trajner në punë (job coach) – personi i rritur me dëmtim intelektual mund të ketë nevojë për trajner i cili do t'i ndihmojë t'i përshtatet rutinës dhe kërkesave të punës kur të fillojë punën në tregun e hapur të punës.

Përkrahës (supporter) – individi me dëmtim intelektual nga koha në kohë mund të ketë nevojë për përkrahës i cili mund t'i ndihmojë të shpreh vizionet e tij dhe ta përkrahë atë në mbrojtjen e qasjes së tij në të drejtat e njeriut.

Materiale të thjeshtëzuara leximi (simplified reading materials) – materiale të cilat kërkojnë aftësi të vogël leximi por të cilat merren me tema për të riturit duhet të zgjerohen. Për shembull, libër i nivelit fillestar i cili merret me menaxhimin financiar mund të ndihmojë individin me dëmtim intelektual.

3.2.5 Vështirësitë emocionale dhe të sjelljes

Emotional and behaviour difficulties

Vështirësitë emocionale dhe të sjelljes shkaktojnë probleme në shtëpi, shkollë dhe në shoqëri. Personat e tillë janë në konflikt me veten e tyre dhe me të tjerët. Ata kanë probleme në ballafaqimin me aspekte të ndryshme të jetës së

përditshme, krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve, tejkalimin e ndjenjave të këqia siç janë pafuqia, frika dhe ankthi.

Në disa raste, njerëzit gjithashtu mund të kenë probleme në kuptimin ose interpretimin e realitetit, p.sh. shohin dhe dëgjojnë gjëra të cilat nuk ekzistojnë. Trajtimi përfshin këshillimin, përkrahjen nga familja, ndihmën personale dhe barërat (medikamentet) të cilat janë të nevojshme të aftësojnë personin me dëmtim kronik psikiatrik të jetojë i pavarur në bashkësi.

Vështirësi në sjellje, përshtatje sociale (maladaptive behavior, social adjustment) – sjellje e cila pengon zhvillimin e sjelljeve të përshtatshme shoqërore dhe pranimin shoqëror të personit në shoqëri.

Sjellje agresive (aggressive behaviour) – i gatshëm ose që mund të sulmojë ose mund ta nxisë atë. Kjo mund të jetë indikator i jashtëm i trazirave emocionale.

Ankth-i (anxiety) – gjendje kronike e tensionimit, e cila ndikon në tru edhe trup.

Sjellje provokuese (challenging behaviour) – sjellje e cila provokon funksionimin efikas të një mjedisi të veçantë në të cilin individi merr pjesë. Sjellja e individit është jashtë normës së pritur në situatën e dhënë.

Depresion-i (depression) – gjendja e të qenit i mërziur dhe pa entuziazëm ose pa shpresë.

Fobia, frika (phobias)

Stres-çrregullim post-traumatik (post-traumatic stress disorder, PTSD) – është çrregullim në të cilin ngjarjet stresuese të përjetuara më parë në aspektin psikologjik përjetojnë disa herë, të shoqëruara me ankth dhe frikë.

Rehabilitim (rehabilitation) – riedukim, veçanërisht kur individi ka qenë i sëmurë ose i lënduar, për t'i mundësuar të bëhet i aftë për aktivitetet ditore.

3.2.6 Dëmtimet e shumëfishta

Multiple impairments

Dëmtimet e shumëfishta janë dëmtime shoqëruese, si p.sh. dëmtimi intelektual – dëmtimi ortopedik etj. Individët me dëmtime të shumëfishta shpesh kanë vështirësi të mëdha për të pasurr pjesëmarrje të plotë në jetën e bashkësisë. Janë të nevojshme përpjekje të veçanta për përfshirjen e tyre në rrjedhat kryesore të aktiviteteve të bashkësisë.

4. Problemet në të folur, komunikim, gjuhë dhe problemet matematikore

Speech, Communication, Language, and Mathematical Problems

Problemet në të folur, komunikim dhe gjuhë janë ndër vështirësitë më të shpeshta për fëmijët. Vështirësitë në të folur luhaten nga probleme të lehta në artikulum deri në mutizëm të plotë.

Problemet gjuhësore në fillim shfaqen si zhvillim i vonuar i të folurit ndërsa gjatë moshës shkollore si vështirësi në lexim, shkrim dhe mësimimin e matematikës.

Vështirësia në të mësuar paraqitet në një ose më shumë procese psikologjike bazë që përfshijnë kuptimin ose përdorimin e gjuhës, të folur ose të shkruar, ose matematikë. Fëmiju me vështirësi në të mësuar nuk mund të përfitojë nga metodat dhe materialet që përdoren në klasat e rregullta pa ndihmë të veçantë arsimore. Ai / ajo nuk do të mund të arrijë ose nuk është duke arritur rezultatet e pritura. Vështirësitë në të mësuar shfaqen si vështirësi të lehta ose të rënda në perceptim (në të kuptuar), konceptualizim, gjuhë, të mbajturit mend, aftësitë motorike dhe kontrollin e vëmendjes.

Ky sektor nuk përfshin fëmijët të cilët kanë vështirësi në të mësuar, të cilat vështirësi para së gjithash janë rezultat i dëmtimit të të pamurit, dëgjimit, dëmtimit fizik, intelektual, emocional dhe vështirësive në sjellje.

Disa terme lidhur me vështirësitë në të folurit dhe në të mësuar

Çrregullim, mungesë e vëmendjes (attention-deficit disorder) – gjendje që manifestohet me vështirësi për tu përqëndruar në informacion dhe për të qenë i vëmendshëm. Personi duket si ëndërrues.

Mungesë e vëmendjes/çrregullim i aktivitetit, hiperaktiviteti (attention deficit / hyperactivity disorder, ADHD) – gjendje e cila manifestohet me vështirësi për tu përqëndruar në informacion, për të qenë i vëmendshëm, dhe me sjellje hiperaktive.

Afazia (aphasia) – personat e rritur që kanë vështirësi për të komunikuar me fjalë si rezultat i goditjes ose dëmtimit të trurit si pasojë e traumës.

Autizmi (autism) – vetëabsorbim, gjendje mendore serioze e cila zhvillohet në fëmijëri, në të cilën personi ka vështirësi në komunikim ose në krijimin e marrëdhënieve me të tjerët për arsye të rigjeditetit të tepërt. Pavarësisht nga problemet, personi mund të ketë fuqi të madhe.

Problem në komunikim (communication problem) – problem në pranimin e informacionit dëgjimor (auditor), në përdorimin e gjuhës, ose në nxjerrjen (artikulimin) e fjalëve e cila ndikon në procesin e këmbimit të ideve dhe shprehjen e ndjenjave.

Problemet e të shprehurit gjuhësor (expresive language problems) – vështirësitë për tu shprehur me fjalë.

Problemet në të kuptuarit e gjuhës (receptive language problems) – probleme në pranimin dhe kuptimin e komunikimit gojor (verbal) ose atij me shkrim.

Disleksi-a, (dyslexia) – sindromë në të cilën personi ka vështirësi të jashtzakonshme dhe të përhershme në të mësuarit e komponentave të fjalëve dhe fjalive, në integrimin e tyre në fjalë apo fjali dhe në të mësuarit e llojeve të tjera të sistemeve treguese siç është të treguarit e kohës, drejtimit, shkaqeve.

Referencat

- Abberly, P. 1996. The Concept of Oppression and the Development of a Social Theory of Disability. In Barton, L. & Oliver, M. (Eds.) Disability Studies: Past, Present and Future. Leeds: Disability Press.
- Diagnostic and Management for Mental Disorders in Primary Care: ICD-10 Chapter V Primary Care Version. 1996. WHO Guidelines. Göttingen: Hogrefe & Huber Publishers.
- An Empowerment Tool, Pocket Guide to Disability Equity for Leaders of persons with Disabilities. 2000. Africa Decade of Disabled Persons. Disabled People South Africa (DPSA).
- Glossary related to disability and education. 1997. CD-ROM. Teaching Students with Disabilities, The state of Queensland, Department of Education.
- Guidance on matters to be taken into account in determining questions relating to the definition of disability. 1995. Disability Discrimination Act.
- Oliver, M. & Barnes, C. 1998. Disabled people and Social Policy: From Exclusion to Inclusion. London: Longman.
- Oxford Advanced Learner's Dictionary. Fifth edition. 1995. Oxford: Oxford University Press.
- People with disabilities during Humanitarian Crisis, Identification Mission Kosovo, November 23rd – 27th 1999. 1999. Copenhagen: The Danish Council of Organizations of Disabled People.
- The Standard Rules on Equalization of opportunities for Persons with Disabilities. 1994. United Nations.
- The World Disability Report. 1999. Disability '99. The International Disability Foundation in association with the Winchester Group.
- Udhëzimet për diagnostikim dhe trajtim të çrregullimeve mentale në kujdesin parësor: ICD-10 kapitulli V versioni i kujdesit parësor. 1996.
- Webster's Encyclopedic Unabridged Dictionary of the English language. 1996. New York: Gramercy books.
- Weller, B. F. (Ed.) 2000. Bailliere's Nurses' Dictionary. China: Bailliere Tindall.

POLITIKA E ARSIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOSOVË (Projekt-dokumenti i politikës që do të jetë pjesë e “Korniza gjithpërfshirëse mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë”)

1. HYRJE

Qasja në çështjen e aftësisë së kufizuar duke u bazuar në sferën e të drejtave të njeriut dhe proceset zhvillimore ka ndikim të rëndësishëm për mënyrën në të cilën ofrohet arsimi. Mësimdhënësit përpiqen të klasifikojnë personat me aftësi të kufizuar në bazë të aftësisë së kufizuar. Në këtë mënyrë, nxënësit me aftësi të kufizuar janë vendosur në shkolla ose klasë speciale ose janë përjashtuar nga çdo mundësi e arsimimit me arsytim se kanë “kufizim të rëndë të aftësisë”. Kjo natyrisht rezulton me analfabetizëm dhe nivel të ulët të kualifikimit, veçanërisht midis të riturve me aftësi të kufizuar, duke i kontribuar në këtë mënyrë nivelit të lartë të papunësisë dhe varfërisë.

Fëmijët me aftësi të kufizuar kanë shumë pak ose aspak mundësi për t'u kyçur në arsim kualitativ. Përpjekja e tyre për t'u kyçur në arsimin e rregullt me bashkëmoshatarët e tyre është mirë e dokumentuar. Përvoja ndërkombëtare ka treguar se pengesat e fëmijëve me aftësi të kufizuar për t'u kyçur në sistemin e rregullt arsimor mund të adresohen vetëm përmes legjisllacionit që mbështet këtë dhe lobimit aktiv. Ky legjisllacion duhet të përfshijë njohjen e të drejtave themelore të njeriut të çdo fëmiju për t'u kyçur në procesin arsimor i cili nuk është diskriminues.

Arsimimi, tradicionalisht është përqëndruar në vitet e kaluara në shkollë e në masë më të vogël në arsimin terciar. Lidhjet me sferën e punës dhe trajnimit kanë qenë të dobëta. Ndryshimet në politikën e arsimit kanë rëndësi të veçantë për forcimin e ardhshëm ekonomik të personave me aftësi të kufizuar.

Me qëllim të shqyrtimit të politikës së arsimit në lidhje me personat me aftësi të kufizuar, do të fillojmë me definicionin çka nënkuptohet me nevoja të veçanta në arsim dhe arsimin përfshirës, meqenëse kuptimi i këtyre dy koncepteve ndryshon. Për qëllimet e këtij dokumenti politik shqyrtojmë definicionet vijuese:

“Arsimi dhe trajnimi përfshirës:

- *Pranon se të gjithë fëmijët dhe të rinjtë mund të mësojnë dhe se të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për përkrahje.*
- *Ofron përmirësimin e strukturave arsimore, sistemeve dhe metodologjive mësimore me qëllim të plotësimit të nevojave të nxënësve/studentëve (përvetësuesve).*
- *Njeh dhe respekton dallimet midis nxënësve, qoftë për shkak të moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, gjuhës, klasës, aftësisë së kufizuar, statusit të HIV-it, etj.*
- *Është më i gjërë se shkollimi formal dhe pranon se të mësuarit (përvetësimi) gjithashtu kryhet në shtëpi dhe bashkësi si dhe në kuadër të formës formale dhe joformale.*
- *Ndryshon qëndrimet, sjelljet, metodologjitë, programin dhe mjediset me qëllim të plotësimit të nevojave të të gjithë nxënësve.*
- *Rrit pjesëmarrjen e nxënësve në kulturë dhe plan programin e institucioneve arsimore dhe minimizon pengesat në të mësuar”.*

(letra e bardhë mbi arsimin në Afrikën jugore 6 qershor 2001)

Në këtë mënyrë arsimi përfshirës nuk merret vetëm me përgatitjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar por gjithashtu edhe me ndryshimet fundamentale në mënyrën si ne shohim shumëllojshmërinë në klasë dhe në mbarë shoqërinë.

Termi nevoja të veçanta në arsim është gjithashtu një term i cili është më i gjërë dhe që nuk lidhet vetëm me çështjen e aftësisë së kufizuar. Ai paraqet çdo lloj përgatitje

arsimore. Ky term paraqet çdo përgatitje arsimore që duhet bërë përveç përgatitjes arsimore të rregullt me qëllim që t'i përgjigjet personit të veçantë ose "nevojave të veçanta". Në këtë mënyrë fëmiju me aftësi të kufizuar mund të mos ketë nevojë për arsimim të veçantë (psh, për fëmijun që ka kufizim të lehtë fizik të aftësisë). Fëmiju që nuk ka kufizim të aftësisë mund të ketë nevojë për arsimim të veçantë (special) (psh, fëmijët që kanë trauma nga lufta).

Gjithashtu e rëndësishme është të bëhet dallimi midis arsimit të rregullt dhe atij përfshirës. Arsimi i rregullt haset në rastet kur fëmiju me aftësi të kufizuar kyçet në klasë të rregullt me pak ose aspak ndryshime të klasës ose të programit mësimor. Fëmiju do t'ia dale mbanë të përballojë në këtë mjedis vetëm nëse ai ose ajo përkundrejt aftësisë së kufizuar ka pasur sukses të arrijë nivelin e duhur të dijes (njohurive). Fëmiju duhet t'i përshtatet sistemit. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuar ose me nevoja të posaçme kryesisht lidhet me të drejtat themelore të njeriut për fëmijun që ai të arsimohet me moshatarët e tij. Që kjo e drejtë t'iu mundësohet të gjithë fëmijëve, duhet të ndryshojnë shkollat dhe sistemi arsimor me qëllim që të jenë më të përshtatshme. Sistemi duhet t'i përshtatet fëmijut. Psh, do të ishte shumë e vështirë kyçja e fëmijut me dëmtim të rëndë mendor në arsim të rregullt meqenëse ai nuk do të ishte në gjendje të funksionojë në të njëjtin nivel si pjesa tjetër e klasës dhe nuk do të mund t'ia dilte mbanë me programin e rregullt mësimor. Mirëpo do të ishte e mundur që fëmiju të kyçej aty ku rezultatat e të mësuarit janë përshtatur nevojave të fëmijut. Kjo do të kërkonte një program fleksibël arsimor si dhe individualizimin e qëllimeve. Ne do të duhej të ndryshonim pritjet tona në lidhje me atë se do të bëjmë fëmijun "më normal" për të siguruar pjesëmarrjen maksimale të tyre në jetën e përditshme.

Arsimi përfshirës përqëndrohet në identifikimin dhe largimin e pengesave në të mësuar (përvetësim) dhe pjesëmarrje. Në vend të përpjekjes për t'i bërë individët më "normal", duhet theksuar përpjekja për krijimin e një ambienti "më normal" për individët. Pengesat për nxënësit me aftësi të kufizuar mund të përfshijnë ndërtesat e papërshtatshme (pa mundësi qasjeje në to). Sidoqoftë, pengesat janë edhe më të mëdha se kjo dhe përfshijnë programin e papërshtatshëm mësimor, pengesat gjuhësore, pritjet (shpresat) e vogla, qëndrimet negative dhe stereotipet lidhur me aftësinë e kufizuar dhe dallimet tjera. Pengesat në të mësuar (përvetësim) gjithashtu mund të rezultojnë nga faktorët socio-ekonomik siç është varfëria apo përkatësia në klasat e shoqërisë. Sistemi i arsimit përfshirës përqëndrohet në lëvizjen apo largimin e këtyre pengesave në përpjekjet e vazhdueshme për të mundësuar arsimim për të gjithë.

Të gjithë njerëzit duhet të kenë mundësi të barabartë për t'u arsimuar, pavarësisht nga aftësia e kufizuar e tyre. Çdo nxënës ka aftësi dhe nevoja të caktuara për të mësuar. Respekti për shumëllojshmërinë duhet të theksohet dhe të avancohet. Të gjithë njerëzit duhet të kenë qasje në të gjitha mundësitë e arsimit dhe mjedisit normal social; të arsimohen dhe trajtohen në një mjedis sa më normal të mundshëm; sigurimi i barazisë për nxënësit me aftësi të kufizuar brenda mjedisit përfshirës.

Idetë themelore të arsimit përfshirës mund të gjenden në shumë dokumente të mëhershme politike:

Konventën mbi të drejtat e fëmijut të 1989

- e drejta e fëmijut me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar dhe trajnuar - me qëllim të arritjes së shkallës më të lartë të vetëbesimit dhe integritetit social.
- arsimimi do të synojë në zhvillimin e plotë të personalitetit, talenteve dhe aftësive mendore dhe fizike të fëmijut.

Deklarata Botërore Jomtien mbi arsimimin për të gjithë 1990.

- arsimim për të gjithë
- dallimet individuale janë pranuar si sfida dhe jo si problem

Rregullat standarde mbi barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuara 1993

- autoritetet arsimore janë përgjegjës për arsimimin e personave me aftësi të kufizuara në mjediset e integruara: planifikimi i arsimit, zhvillimi i plan-programit mësimor dhe organizimi shkollor.

Deklarata Salamanca dhe Korniza për veprim e miratuar në Konferencën botërore mbi nevojat e veçanta në arsim 1994

- shkollat duhet të përfshijnë të gjithë fëmijët pa marrë parasysh gjendjen fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose gjendje të tjera.

- "Nevoja të veçanta në arsimim" I referohet atyre fëmijëve dhe të rinjve nevojat e të cilëve rrjedhin nga aftësia e kufizuara ose vështirësitë në të mësuar.

- Shkollat e rregullta ofrojnë mjetet më efektive për të arritur arsimimin për të gjithë.

2. GJENDJA AKTUALE E ARSIMIT SPECIAL NË KOSOVË

Ky dokument i politikës është nxjerrë në kohën kur situata në Kosovë ende konsiderohet e ndëlikuar. Tensioni politik dhe problemet serioze sociale dhe ekonomike në Kosovë dhe në tërë rajonin ende nuk janë shuar edhe përkundrejt ndryshimeve në Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ) përpjekjeve ndërkombëtare për të stabilizuar rajonin dhe punës së bërë nga organizatat e ndryshme humanitare që nga qershori i vitit 1999.

Në këtë kontekst, ky dokument i politikës ka për synim përkrahjen e NV/AP në kuadër të sistemit të rregullt arsimor në Kosovë përmes përmirësimit të ambienteve shkollore, aftësimit të kuadrove dhe ndërtimit të kapaciteteve institucionale. Ky proces nuk varet vetëm nga ndryshimet e mundshme që do të ndodhin në rrethin e brendshëm dhe të jashtëm politik dhe social të saj. Si i tillë, me kujdes do t'i shmanget qasjes së pabarabartë, do të zhvillohet dhe do t'i përkrahë të gjitha grupet – etnike dhe profesionale, lokale dhe ndërkombëtare, organet administrative dhe jo-qeveritare, nevojat e veçanta/personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat lokale të tyre.

Sa i përket procesit dhe rezultateve, politika synon të jetë fleksibile, përfshirëse, të inkurajojë pjesëmarrjen dhe pronësinë e vërtetë të gjithë atyre që janë të angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Filozofia themelore e këtij dokumenti të politikës është përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e procesit të reformave në arsim duke filluar nga projektimi, planifikimi, zbatimi dhe vlerësimi, e deri te sjellja e vendimit.

2.1.Politika e Qeverisë dhe e sektoreve

2.1.1. Strukturat Institucionale dhe Administrative. Departamenti për Arsim dhe Shkencë

Për sa i përket arsimit, menjëherë pas luftës (1999), në mars të vitit 2000 u themelua Departamenti i UNMIK-ut për Arsim dhe Shkencë (DASH), me personelin e tij të përbërë prej edukatorëve lokalë dhe ndërkombëtarë. DASH-i është përgjegjës për administrimin e arsimit dhe udhëheqjen e shkollave në tërë Kosovën, dhe më tej pason me Administratën rajonale dhe dy zyrtarë ndërkombëtarë të arsimit në çdonjërin prej pesë zonave të KFOR-it. Komunitetet përbëjnë institucionet tradicionale të qeverisë lokale. Ato, përkohësisht, drejtohen nga Administratori komunal ndërkombëtar i UNMIK-ut. Personat me nevojë të veçanta dhe arsimi përfshirës janë pjesë e këtij rregullimi. Aktualisht, DASH-i ka një angazhim të rëndësishëm në avancimin e personave me nevojë të veçanta dhe të arsimit përfshirës përmes përkrahjes Finlandeze në Zhvillimin e Sektorit të Arsimit në Kosovë (PFZSAK), të financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës dhe të zbatuar nga një grup ekspertësh të rangut të lartë. Në të njëjtën kohë DASH-i është duke planifikuar që deri në fund të shtatorit të vitit 2001 të punësojë një zyrtar vendas për personat me nevojë të veçanta i cili do të punojë në konceptimin e politikës arsimore dhe në çështjet administrative të personave me nevojë të veçanta/arsimin përfshirës. Ky është një hap i rëndësishëm përpara në gjendjen e tanishme financiare të sektorit të arsimit e cila është mjaft e vështirë.

2.1.2. Gjendja aktuale dhe politikat për personat me nevojë të veçanta/arsimi përfshirës¹⁰

Në shtator të vitit 2000, DASH-i ka përgatitur një dokument lidhur me personat me nevojë të veçanta/arsimin përfshirës (NV/AP) në Kosovë.¹¹ Objektiva kryesore e përmendur në dokument është “të ofrohet arsimimi i duhur për personat me nevojë të veçanta dhe të sigurohet që fëmijët me kufizime të veçantë të aftësisë të përfshihen në arsimin e përshtatshëm dhe kualitativ në Kosovë”.

Në bazë të këtij dokumenti (fq.1), “numri i fëmijëve të regjistruar në Kosovë në fund të vitit shkollor 1999/2000 është 400.000. Nga vlerësimet e dhëna lidhur me kufizimin e rëndë të aftësisë (1%), numri i mundshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara është 4000. Aktualisht, numri i fëmijëve dhe të rinjve të cilët vijojnë mësimin në 11 klasë ekzistuese për nxënësit me aftësi të kufizuara në kuadër të shkollave speciale dhe atyre të rregullta, është më i vogël se 500.

Këtu gjithashtu duhet të marrim parasysh se me siguri në arsimin e rregullt ka shumë fëmijë të cilët kanë nevojë të veçanta të cilat nuk janë plotësuar. Shumë nga këto lidhen me aspektet e përmendura në definimin e arsimit përfshirës më sipër, por gjithashtu duhet cekur se ka shumë fëmijë me aftësi të kufizuara të cilët janë ende të

¹⁰ Shiko , Fetah Bylykbashi, Arsimimi i personave me nevojë të veçanta në Kosovë: *histori e shkurtë* (shqip). Paraqitur gjatë seminarit për arsimin e personave me nevojë të veçanta, 25 tetor 2000 (dokument i pabotuar).

¹¹ Shiko *Arsimi i personave me nevojë të veçanta—shtator 2000: Vështrim*, Prishtinë, 2000.

pazbuluar – me dëmtime të të dëgjuarit, të pamurit dhe me çrregullime emocionale. Për këtë arsye identifikimi dhe plotësimi i këtyre nevojave në shkollat e rregullta gjithashtu duhet të përfshihet në politikën e arsimit përfshirës.

Duke u nisur nga të dhënat që ofrohen nga ky dokument, nga vizitat në terren dhe analizat e kryera nga ekipi i PFZSAK, arsimimi i personave me aftësi të kufizuar ofrohet në tre fusha – dëmtimin e të dëgjuarit, të pamurit dhe atë intelektual . Në Kosovë ekzistojnë pesë shkolla për personat me nevoja të veçanta. Për çdonjërin lloj të aftësisë së kufizuar ka një ose dy shkolla të specializuara (në Prishtinë – për personat me dëmtim intelektual; Prizren – një për personat me dëmtim të të dëgjuarit dhe një për personat me dëmtim intelektual; Pejë – për personat me dëmtim të të pamurit; Mitrovicë – për personat me dëmtim intelektual).

Në shtator të vitit 2000 në Shtime është krijuar një spital-shkollë për një numër të vogël të fëmijëve me dëmtim intelektual. Përveç kësaj, shkollimi për personat me aftësi të kufizuar përkrahet përmes një numri të caktuar të klasëve speciale që janë bashkangjitur shkollave të rregullta (Prishtinë, për personat me dëmtim të të dëgjuarit, Gjilan – dëmtime të ndryshme; Mitrovicë me një shkollë të vogël për NV për serbët).

Për personat me aftësi të kufizuar fizike (d.m.th. fëmijët me paralizë cerebrale, sëmundje kronike, me amputime) ose për fëmijët me vështirësi në të mësuar nuk ekzistojnë kushte sistematike. Në Kosovë ende nuk ekziston arsimi përfshirës, përveç në disa raste të veçanta ku në shkollat e rregullta janë bashkangjitur klasë për fëmijët me nevoja të veçanta (Prishtinë, Gjilan).

Parimi kryesor i politikës së arsimit që mbështet punën e DASH-it sa i përket personave me aftësi të kufizuar është ai i përfshirjes, në bazë të të cilit “nxënësit me kufizim më të lehtë të aftësisë duhet të integrohen në klasët e rregullta në vend se të veçohen në shkolla speciale”. Sido që të jetë, DASH-i është i vetëdijshëm për faktin se ky do të jetë një proces i gjatë dhe i mundimshëm (vlerësimet e para flasin për afër 10 vite) dhe zbatimi i tij mund të bëhet vetëm në bazë të qasjes graduale “hap-pas-hapi”.

Në kuadër të këtij vizioni si themelore janë parë masat politike vijuese:

- të forcohen strukturat ekzistuese (p.sh. shkollat/klasat për nevojat e veçanta) për ata me kufizim të rëndë të aftësisë.
- të ngritet vetëdija dhe pranimi përmes rrjedhës kryesore duke sistemuar përkrahjen adekuate për fëmijët, të rinjtë dhe mësimdhënësit e tyre.

Në këtë kontekst, DASH-i parasheh dy hapa kryesorë. Për momentin DASH-i ndodhet në hapin e parë, duke u përpjekur të mbulojë (përkojë) pjesërisht edhe me hapin e dytë:

- **Hapi 1** synon restaurimin e disa shkollave speciale, duke hapur një shkollë për fëmijët të cilët ndodhen në institucionin psikiatrik; duke planifikuar një shkollë spital, duke përgatitur një shkollë për fëmijët me dëmtime të rënda fizike, si dhe organizimin e një numri sesionesh për trajnimin e personelit gjatë punës në këto shkolla (që do të kryhen kryesisht nga OJQ-të ose projektet ndërkombëtare, duke përfshirë PFZSAK).
- **Hapi 2** synon të bind Univerzitetin e Prishtinës se të gjitha kurset e zakonshme afat shkurtëra të zhvillimit profesional të mësimdhënësve para- dhe/ose gjatë-shërbimit duhet të përmbajnë udhëzime të qarta lidhur me parimet e përfshirjes. Ai poashtu shqyrton përkrahjen e rinteprimit të fëmijëve me kufizim të lehtë të aftësisë në klasë të rregullta.

Në korrik të vitit 2000, DASH-i i UNMIK-ut ka zhvilluar konceptin e agjencive udhëheqëse. Kjo iniciativë është e re për institucionin arsimor në Kosovë. Agjencitë udhëheqëse trajtohen si kyç në hartimin e politikës dhe bashkërendimin e organeve në sektorë të ndryshëm edhe pse ato nuk janë themeluesit e vetëm të veprimtarive në të cilat ato bashkërendojnë. DASH-i i UNMIK-ut ka ftuar organizata dhe projekte të ndryshme ndërkombëtare për të vepruar si agjenci udhëheqëse për sektorë të ndryshëm të politikave arsimore . Përkrahja Finlandeze në zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë (PFZSAK) është caktuar si agjenci udhëheqëse për këtë sferë të interesimit. Në të njejtën kohë PFZSAK ka zhvilluar bashkëpunim të frytshëm me UNICEF-in, agjenci udhëheqëse për zhvillimin e planprogramit (kurrikulumit) dhe me CIDA-n Kanadë, agjenci udhëheqëse për trajnimin e mësimitdhënësve. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i shkëlqyeshëm mes këtyre tri organizatave është një nga mundësitë më të mira për mbështetjen e ndryshimeve të mëtejshme në sektorin e arsimit.

2.1.3. Gjendja aktuale dhe politikat për zhvillimin e resurseve njerëzore dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale

Ristrukturimi i zhvillimit të resurseve njerëzore para- dhe gjatë-shërbimit si dhe ndërtimi i kapaciteteve të shkollave – çështjet e NV/AP të përfshira – për momentin, konsiderohen si vendimtare në hartimin e politikës globale dhe të sektorit të arsimit në Kosovë

Për sa i përket *trajnimin të mësimitdhënësve para- dhe gjatë-shërbimit*, deri në shtator 2000 nuk ka ekzistuar strukturë institucionale e cila do të merrej me trajnimin e mësimitdhënësve për çështjet NV/AP. Sido që të jetë, një sërë OJQ ndërkombëtare dhe vendore (si UNICEF-i, Handicap International, Handikos, Oxfam, etj.) menjëherë pas luftës nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut kanë filluar trajnimin e mësimitdhënësve para- dhe gjatë-shërbimit lidhur me nevojat e veçanta dhe arsimin përfshirës.

PFZSAK aktualisht është duke implementuar projektin e parë afat-gjatë dhe sistematik në fushën e zhvillimit profesional për nevojat e veçanta/arsimin përfshirës¹² të filluar në shtator të vitit 2000. Në kuadër të këtij projekti deri në vitin 2003 do të realizohen tre komponentet kryesore: (a) Zhvillimi dhe përkrahja e politikës së arsimit, (b) Zhvillimi profesional për trajnerët dhe hartuesit e ardhshëm të politikës në këtë fushë; (c) Trajnimi për përmirësimin e shkollave dhe zhvillimin e procesit. Avancimi i një numri trajnimesh dhe përkrahja për vazhdimin e sesioneve mbi arsimin përfshirës është realizuar në kuadër të këtij projekti midis nëntorit të vitit 2000–shtatorit të vitit 2001.

Në të njejtën kohë, pjesëmarrësit ndërkombëtarë dhe ata vendor me këtë projekt për herë të parë janë pajtuar mbi përmbajtjen e trajnimit (DASH-i, Handikos-i, Oxfam-i, drejtorët dhe mësimitdhënësit e shkollave/klasëve të rregullta dhe atyre për nevoja të veçanta, personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre, etj.). DASH-i si dhe partnerët tjerë vendor dhe ndërkombëtarë (UNICEF-i, Handikos-i etj.) i kanë konsideruar këto veprimtari si kontributin më të ndërlikuar në zhvillimin e resurseve njerëzore për arsimin përfshirës që prej vitit 1999.

2.2. Sfondi i dokumenteve të shfrytëzuara

¹² Shih *Drejt arsimit për të gjithë. Përkrahja Finlandeze në Zhvillimin e Nevojave të veçanta dhe Arsimit përfshirës në Kosovë . Projekt Dokumenti (Zbatimi I planit dhe buxhetit)*. PFZSAK – Prishtinë, Ministria e punëve të jashtme – Helsinki, janar, 2001 (dokument i pabotuar).

Ekzistojnë disa dokumente mbi politikën e arsimit të përgjithshëm dhe atë sektorial të cilat mund të merren parasyshtë gjatë hartimit të politikës mbi nevojat e veçanta/arsimin përfshirës të DASH-it (UNMIK). Këto mund të ndahen në tri grupe vijuese:

a. Analizat. Dokumentet mbi politikën e përgjithshme të arsimit. Këshilli Britanik (British Council, gusht 1999), UNMIK-u (Mars 2000), Ministria e punëve të jashtme e Finlandës (prill 2000) dhe Banka Botërore (njësia për Evropën dhe Azinë qendrore, gusht 2000) kanë zhvilluar dokumentet më të rëndësishme deri më tani. Sa i përket nevojave të veçanta/arsimit përfshirës, Handikos-i, një nga OJQ-të më të rëndësishme vendore, ka bërë punë të rëndësishme në identifikimin e personave me nevoja të veçanta/aftësi të kufizuar. Pritet që baza e të dhënave dhe shënimet e tjera statistikore të jenë burim i rëndësishëm i informimit, pasi që ky dokument mbi konceptin, përqëndrohet në përkrahjen e politikës së arsimit përfshirës.

b. Studimet lidhur me NV/AP në Kosovë. Falë përkrahjes së dhënë qendrës për arsim në Kosovë (KEC) nga Ministria e punëve të jashtme e Finlandës, këshilltari special për arsim pranë KEC-it në gusht të vitit 2000 ka shkruar raportin e pare për NV/AP. Poashtu ekziston edhe raporti i bërë nga një ekspert lokal i DASH-it mbi historinë e NV/AP në Kosovë. Këto studime identifikojnë problemet dhe prioritetet dhe si të tilla mund të inkurajojnë qasjen plotësuese në përkrahjen e arsimit përfshirës.

c. UNMIK - Dokumentet dhe raportet mbi politikën e arsimit. Duke filluar me implementimin e *Sekretariatit të Arsimit* në kuadër të administrimit civil të UNMIK-ut, dokumentet e para mbi politikën e arsimit janë nxjerrë në shtator, pastaj në dhjetor 1999 (shih “Plani Strategjik i UNMIK-ut – Sektori i Arsimit” dhe “Marrëveshjet e përkohshme mbi arsimin shkollor në Kosovë”). Dokumentet përcaktojnë objektivat afat-shkurte, afat-mesme dhe afat-gjata, synimet e sektorit të arsimit, hapat e mëtejshëm strategjikë dhe kuadrin e veprimt. Këto dokumente theksojnë rëndësinë e ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe zhvillimin e resurseve njerëzore në të ardhmen duke përfshirë edhe aftësimin e mësimdhënësve.

(d) Si agjenci udhëheqëse për nevoja të veçanta në arsimim, në shkurt 2001 PFZSAK, ka përgatitur dhe i ka prezentuar DASH-it një “projekt-dokument i politikës mbi nevojat e veçanta dhe arsimin përfshirës në Kosovë: gjendja aktuale dhe perspektivat”. Ky dokument ka qenë bazë e cilit do qoftë zhvillimi të mëtejshëm të politikës mbi çështjen e arsimimit të personave me nevoja të veçanta në Kosovë.

2.3. Problemet që duhen trajtuar

2.3.1. Problemet e përgjithshme në arsim

Siç është e njohur, gjatë sistemit paralel (1990-1998) të gjithë sektorët e arsimit kanë pësuar mjaft. Kualiteti i arsimit ka shënuar rënie dhe ekspozimi ndaj modeleve perëndimore ka pushuar së ekzistuari për më shumë se dhjetë vite. Si pasojë e

gjendjes së ndjeshme dhe të paqëndrueshme pas luftës si dhe traditave historike dhe kulturore të arsimit në Kosovë, zbatimi i cilësdo reforme nuk do të jetë e lehtë dhe pa kundërthënie. Për sa i përket sistemit të arsimit dhe çështjes së arsimit special/përfshirës, shumica e studimeve ndërkombëtare dhe vendore nxjerrin në pah këto probleme të përgjithshme:

- Planifikimi strategjik dhe hartimi i politikave të arsimit ndodhen në fazën fillestare.
- Sistemi arsimor nuk është i rregulluar mirë, kryesisht funksionon kundër rregulloreve ad-hoc.
- Madhësia dhe struktura e popullatës në moshën shkollore ende nuk është e sigurtë.
- Fëmijët dhe mësimdhënësit kanë përjetuar dhe kanë qenë dëshmitarë të dhunës dhe vdekjes.
- Arsimimi i personave me nevoja të veçanta (ANV) është shumë prapa për të arritur standardet përkatëse përderisa *arsimi përfshirës praktikisht nuk ekziston*.

2.3.2. Problemet lidhur me nevojat e veçanta/arsimin përfshirës

Në përgjithësi, pas luftës dhe krizës në arsim gjatë viteve të nëntëdhjeta statistikak tregojnë se *NV/AP në Kosovë ka qenë ndër më të varfërat në Evropë*. Kriza ka sjellë edhe disa probleme tjera. Statistikat tregojnë për një nivel relativisht të lartë të personave me kufizim të lehtë të aftësisë. Për fëmijët me aftësi të kufizuar mbi 14 vjeç nuk është ofruar asnjë lloj arsimimi.

Për të identifikuar, analizuar dhe trajtuar problemet e veçanta të pëfshirjes së personave me aftësi të kufizuar, ekipi i PFZSAK-së që punon në këtë fushë ka organizuar aktivitetet në vijim:

- (a) seminare të orientuara në proces dhe problem me qëllim të identifikimit të çështjeve dhe prioriteteve në këtë fushë (me përfaqësuesit e organizatave vendore të personave me nevoja të veçanta/personave me aftësi të kufizuar);
- (b) punëtori ose mbledhje me të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në procesin e zhvillimit dhe implementimit të politikës (përfaqësues të donatorëve të ndryshëm dhe organizatave aktive në terren);
- (c) pjesëmarrje në organet e hartimit konkret të politikës (projekti i PFZSAK i është paraqitur *Grupit punues për përgatitjen e një dokumenti mbi politikën e arsimit lidhur me përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar*, në agjencinë udhëheqëse për zhvillimin e planprogramit, aftësimin e mësimdhënësve, trajnimet profesionale, si dhe në komisionin bashkërendues të OJQ-ve vendore dhe atyre ndërkombëtare);
- (d) analizën e nevojave të mësimdhënësve, nxënësve, prindërve, shkollave, vizitat në terren në shkollat/klasat e rregullta dhe speciale; intervistat, vëzhgimet në ambientet konkrete arsimore.

Problemet e përgjithshme të arsimit të identifikuar gjatë këtyre veprimtarive mund të grupohen në kategoritë vijuese:

- problemet që kanë të bëjnë me ambientin dhe infrastrukturën arsimore (ndërtesat, ambientet, pajisjet, qasja e personave me aftësi të kufizuar)
- problemet që kanë të bëjnë me qeverisjen (strukturat institucionale; detyrat institucionale, grupe dhe individuale; ndarja e detyrave midis institucioneve, përfshirja e mekanizmave ndërlidhës si referencat, nxitjet, përdorimi efikas i resurseve, politikave më të mira, planifikimi dhe kontrolli)
- problemet që kanë të bëjnë me personelin, punësimin e personelit/trajnimin e tyre (njohuritë, aftësitë dhe përvojat).

2.3.3. Problemet që duhet trajtuar politika e mëtejme për NV/AP

Veprimtaritë e kryera gjatë analizave të gjendjes kanë siguruar një koncensus në bazë të cilit – me qëllim të kyçjes në sistemin e rregullt – nevoja për përmirësimin e hartimit të politikës, zhvillimit të resurseve njerëzore dhe kapaciteteve institucionale paraqesin prioritet absolut¹³. Lidhur me këtë aspekt gjatë fazes përgatitore janë identifikuar tetë probleme kryesore. Të gjithë ato janë të rëndësishme për zhvillimin dhe implementimin e mëtejme të politikës:

1. Problemi i parë: *kornizë joadekuate politike, ligjore dhe institucionale lidhur me përfshirjen si dhe zhvillimi joadekuate i resurseve njerëzore i cili mund të përkrahë përfshirjen*. Veçori e përbashkët e shumë sistemeve në tranzicion – e Kosova nuk bën përjashtim – është reformimi i arsimit pa një politikë dhe vision të qartë dhe koherent. Politikës mbi nevojat e veçanta/aftësinë e kufizuar i mungon koherenca dhe përputhshmëria. Hartimi i politikës është bërë pa një partneritet të vërtetë midis gjitha palëve përkatëse, dhe në radhë të parë të personave me aftësi të kufizuar. Hartimi i politikës koherente, zhvillimi i resurseve njerëzore dhe projekti i ndërtimit të kapaciteteve institucionale – shembull i kësaj është PFZSAK-ja – do të jenë, pa dyshim, themeli dhe pikënisja e zhvillimit të gjerë të politikës sektoriale afat mesme dhe afat gjatë lidhur me përfshirjen. Megjithatë kjo paraqet një situatë të vështirë për të punuar, në të ekzistojnë mundësi të fshehura. Implementimi i arsimit përfshirës kërkon zhvillimin e përgjithshëm të mbarë sistemit të arsimit. Fakti që përkrahësit e NV do të jenë në gjendje të marrin pjesë në zhvillimin e politikës së përgjithshme nënkupton se ata do të jenë në gjendje të ngulisin parimet e përfshirjes në politikën e përgjithshme të arsimit.

2. Problemi i dytë: *mungesa ose kualiteti i ulët i objekteve dhe infrastrukturës për NV/AP (shkollat, klasat, materialet, furnizimet, etj.)*. Kapaciteti i kufizuar i shkollave speciale, sidomos në zonat rurale ka rezultuar me përjashtimin e shumicës së nxënësve të këtyre vendeve nga mundësia për t'u shkolluar, meqenëse shkollat e rregullta nuk e kanë mundësuar integrimin e tyre.

Sipas studimeve të CRIC-ut (mbykqyrja e familjeve me fëmijë të hendikepuar në bashkësinë e Prishtinës, 8 qershor 2001) pjesëmarrja e fëmijëve me aftësi të kufizuar të moshës 7-14 në shkolla është 57 %. Në pjesët tjera të vendit gjendja pothuaj se është edhe më e rëndë. Vlerësohet që madje mbi 80 % të fëmijëve me aftësi të kufizuar, që kanë arritur moshën shkollore, nuk vijojnë shkollën. Shkalla e analfabetizmit, varfëria, të cilat në përgjithësi lidhen me aftësinë e kufizuar dhe aftësitë e ulta në mesin e të rriturve me aftësi të kufizuar është e lartë. Kjo i kontribuon nivelit të lartë të papunësisë në mesin e personave me aftësi të kufizuar.

3. Problemi i tretë: *kualiteti i dobët i institucioneve që ofrojnë trajnim gjatë shërbimit, aktiviteteve dhe për pasojë edhe i planprogramit trajnues për arsimimin e mësimdhënësve ose ndërtimin e kapaciteteve institucionale drejt qasjes përfshirëse*.

Për çfarëdo lloji analize të nevojave dhe planifikimit afat shkurtë ose afat mesëm të këtyre veprimtarive, përveç PFZSAK-së nuk ekzistojnë dëshmi tjera. Në këtë sferë sistemi nuk ka trajner profesional për mësimdhënësit. Trajnerët e parë do të përgatiten përmes projektit të njejtë të PFZSAK. Aktivitetet e bazuara në trajnimin në shkollë të personelit janë të rralla dhe kualiteti i pjesëmarrësve është i dyshimtë.

¹³ “Aftësimi i mësimdhënësve është prioritet për UNMIK-un dhe partneret e tij. Nevojat urgjente kanë të bëjnë me arsimin e minoriteteve, mbështetjen për trajnimin në-shërbim dhe aftësimin e mësimdhënësve e fëmijëve me nevoja të veçanta.” (Michael Daxner, *Arsimi...*).

4. Problemi i katërt: *aftësi dhe njohuri të pamjaftueshme të mësimitdhënësve, veçmas e aftësisë në përballjen me shumëllojshmërinë në kuadër të procesit mësimitdhënës/përvetësim.* Këto, në masë të madhe, rrjedhin prej arsimit të dobët themelor të mësimitdhënësve në univerzitetet dhe fakultetet për mësimitdhënës, mungesës së plotë të cilit do qoftë trajnimi të veçantë për NV/AP, dhe nga “kultura e defektologëve” e vjetëruar – socialiste - në këtë lëmi. Arsimi përfshirës mund të shihet si diçka më shumë se mësimitdhënje e mirë praktike. Prandaj përmirësimi i trajnimit të përgjithshëm për mësimit aktiv mund të ndikojë në NV dhe trajnimi mbi NV mund të avancojë mësimitdhënjen në praktikë.

5. Problemi i pestë: ofrimi i arsimit joadekuat i cili do të mund të përkrahte mësimitdhënësit për t’u përballë me *sjelljet dhe traumat e shkaktuara nga lufta* si dhe me problemet në arsim pas luftës. Shumë fëmijë kanë pësuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë prej tmerreve të luftës dhe urrejtjes gjatë konfliktit të paradokohshëm. Sistemi shkollor në përgjithësi dhe sidomos mësimitdhënësit ballafaqohen me sfidën se si të zgjidhin këtë problem qenësor, e sidomos atë të përfshirjes. Ka mungesë të edukatorëve të cilët do të ishin në gjendje që të identifikojnë nevojat speciale dhe të shumëllojshme të arsimit dhe të cilët do të gjenin mënyrat e përshtatshme për t’u marrë me këto çështje *si pjesë e mësimitdhënies dhe përvetësimit të rregullt.*

6. Problemi i gjashtë: *statusi i ulët i vërtetimit joadekuat dhe perceptimi i ulët publik për mësuesit që punojnë me personat me aftësi të kufizuara.* Shumica e mësuesve kanë diplomuar në kurset e përgjithshme trajnuese për mësues në univerzitet apo në kolexhet trajnuese. Ata gjatë historisë së tyre të punësimit nuk kanë pasur asnjë lloj profesionalizimi si mësues mbi NV apo AGj. Nganjëherë, kjo situatë ndikon jo vetëm në mendimin të cilën kanë profesionistët e tjerë dhe shoqëria por kjo nënkupton gjithashtu edhe ndikimin negativ në vetë-imazhin dhe vetë-besimin e tyre.

7. Problemi i shtatë: *pikëpamje të prapambetura dhe njohuri të dobta të publikut në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe dallimet ekzistuese.* Pikëpamjet e prapambetura, të dala nga moda, apo mungesa e interesimit të shumicës së kuadrit mësimitdhënës, prindërve, shoqërisë së përgjithshme dhe bashkësisë në drejtim të çështjeve të aftësisë së kufizuar, parimeve përfshirëse dhe gati mosekzistimi i një mekanizmi drejtues me disa nxitje të pakta sociale ndikojnë në kualitetin e përgatitjes arsimore. Zanafilla e problemit, në masë mjaft të madhe, është nga mentaliteti i vjetër sipas së cilit nxënësit me aftësi të kufizuar jo që janë të ndryshëm por ata janë “inferior” dhe përbëjnë një “problem” i cili është më mirë të shmaget. Është e qartë se çdo lloj i hartimit të politikës dhe zhvillimit të resurseve njerëzore për qasje përfshirëse duhet të përqëndrohet në ngritjen e vetëdijes, punën në bashkësi dhe në kontributin e personave me aftësi të kufizuar në hartimin e politikës me qëllim që të bëhet ndryshim rënjsor në të menduarit e popullatës dhe të zmadhohet pjesëmarrja.

8. Problemi i tetë: *motivimi i ulët material për aftësimin e kuadrove, përmirësimin e trajnimit dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale,* edhe nëse mësuesit kanë dëshirë të zhvillojnë në mënyrë profesionale aftësitë dhe njohurinë e tyre. Paga e tanishme mujore e mësuesve është 240 DM. Drejtorët apo ata që kanë të kryer universitetin kanë paga më të larta. Gjithashtu janë të kufizuara mundësitë për të gjetur vende të reja të punës apo përgjegjësi pas një zhvillimit të tillë personal. Jo vetëm që nuk shpërblehet trajnimi, por gjithashtu nuk ka ndonjë sistem stimulimi i cili inkurajon kualitet të mirë të punës.

2.4. Bartësit dhe përfituesit

Pikat në vazhdim kanë për qëllim të paraqesin një përmbledhje të përfundimeve kyçe në lidhje me bartësit dhe përfituesit e mundshëm të kësaj politike në zhvillimin dhe implementimin e saj.

Hartuesit e politikës së arsimit. Bartësi dhe përfituesi kryesor i zhvillimit dhe implementimit të ardhëm të politikës do të jetë DASH-i i UNMIK-ut, si organ kryesor përgjegjës për reformat në arsimin e Kosovës. Dihet mjaft mirë që zhvillimi dhe implementimi i ardhëm i politikës – i cili nisët nga nevojat dhe intereset e nevojave të veçanta/nxënësve me aftësi të kufizuar– merr parasysh prioritetet e reformave të arsimit në Kosovë siç është përcaktuar nga DASH-i i UNMIK-ut së bashku me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë. Procesi i ardhëm i zhvillimit dhe implementimit të politikës së pari pritet të ofrojë një kornizë për referim të mëtutjeshëm të politikave të arsimit në fushën e përfshirjes si dhe në atë të zhvillimit profesional të mësuesve për qasje përfshirëse.

Ofruesit e trajnimit të mësuesve. Universiteti i Prishtinës si dhe fakultete të ndryshme për trajnimin e mësuesve do të ofrojnë ekspertizën vendore në planifikimin dhe zhvillimin e plan-programit mësimor të trajnimit për përfshirje, si dhe do të ofrojnë trajnerë profesionistë për trajnim. Universiteti gjithashtu mund të ofrojë objektet e veta trajnuese si dhe përkrahje të tjera të ndryshme. Universiteti madje mund të zgjedhë kuadrin e ardhëm profesional për arsimin përfshirës nga grupi i të trajnuarve të cilët do të marrin pjesë në aktivitetet e mëtejshme të zhvillimit dhe implementimit të politikës.

Organizata vendore dhe ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuar. Në Kosovë, nuk ekziston ndonjë traditë që personat me aftësi të kufizuar të marrin pjesë në hartimin e politikës dhe strategjisë për bashkësinë e tyre, përfshirë këtu edhe sektorin e arsimit. Si anëtar i *grupit punues mbi çështjen e aftësisë së kufizuar*, PFZHSAK është koordinator për zhvillimin e një politike të arsimit për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në sistemin arsimit të rregullt. Të gjitha organizatat vendore janë të përfaqësuara në grupin punues dhe pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuar në hartimin e një politike të tillë është më e rëndësishmja në historinë e kësaj bashkësie.

Shkollat për fëmijët me nevoja të veçanta janë pjesëmarrës dhe shfrytëzues të rëndësishëm në procesin e zhvillimit dhe implementimit të politikës pasi që ato për momentin janë të vetmit ku mund të shihet një interesim i qartë për arsimin përfshirës. Procesi i zhvillimit të politikave ka për qëllim që të shohë këto shkolla si qendra të mundshme të resurseve për praktikën e mëtejshme të arsimit përfshirës (në të vërtetë, e njëjta gjë vlen për shumë vende të zhvilluara, përfshirë këtu edhe Finlandën). Këto shkolla mund të ofrojnë përkrahje në zgjedhjen e anëtarëve të rinj për pjesën e procesit të zhvillimit të kuadrove njerzore.

Shkollat e rregullta paraqesin mjedis arsimor më të mirë për projektet pilot dhe për realizimin e arsimit të ri përfshirës madje edhe për përmirësimin e procedurave shkollore të cilat inkurajojnë arsimin përfshirës. Në të njejtën kohë shkollat e rregullta janë burim i rëndësishëm i informatave sa i përket aktiviteteve të përditshme në klasë gjë që mund të ngrisë procesin e zhvillimit dhe gradualisht të përshtasë plan-programin mësimor për procesin e zhvillimit profesional që është në zhvillim e sipër. Këto shkolla të rregullta (së paku një në çdo regjion) të cilat do të zhvillojnë modele dhe procedura të përshtatshme për përfshirje, do të inkurajohen në shndërimin e tyre gradual në qendra të resurseve arsimore të cilat kanë për qëllim avancimin e idesë së qasjes përfshirëse. Së fundi, shkollat e rregullta normalisht janë përfituesit kryesorë të procesit të zhvillimit dhe implementimit të politikës.

Mësimdhënësit. Shkollat e rregullta dhe ato speciale (për nevoja të veçanta) nuk kanë kuadër të mjaftueshëm të specializuar, siç janë mësues profesionistë, logopedë, psikologë, pedagogë e kështu me radhë. Sidoqoftë, mësuesit mund konsiderohen si pjesëmarrës të rëndësishëm, pasi që ata janë të parët të cilët mund të paraqesin ide dhe procedura të reja, për shembull si ato që lidhen me arsimin përfshirës. Mësuesit gjithashtu mund të luajnë një rol të veçantë në ngritjen e vetëdijës (të prindërve dhe bashkësisë) së shoqërisë sa i përket ofrimit të arsimit përfshirës në Kosovë dhe në promovimin e pjesmarrjes konkrete të personave me aftësi të kufizuar në planifikimin e arsimimit të tyre. Është shumë e qartë që mësuesit përbëjnë përfituesit e drejtëpërdrejtë në procesin e zhvillimit dhe implementimit të politikës.

Nxënësit me aftësi të kufizuar gjithashtu mund të konsiderohen si pjesëmarrës dhe përfitues. Pjesëmarrësit, duhet të konsiderohen si partnerë dhe aktorë në planifikimin dhe implementimin e arsimimit të tyre dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e mësimdhënies dhe procesit mësimor në klasë. Përfituesit, si rezultat i nxitjes së filozofisë dhe praktikave përfshirëse në klasë do të krijojnë sjellje pozitive ndaj dallimit, dhe do të nxisë tolerancë si dhe do t'u ofrojë qasje në edukim e me këtë mundësi për pavarësi ekonomike në jetën e mëvonshme. Mësimdhënësit gjithashtu mund të jenë një burim i rëndësishëm në shkollë ku ata ndërthurin aftësitë e tyre në zgjidhjen e problemit në mësimdhënie dhe grupeve përkrahëse në të mësuar (përvetësim). Këto grupe mund të risin kapacitetin e shkollave për adresimin e vështirësive në përvetësim në kuadër të vetë shkollës para se të kërkojnë përkrahje nga jashtë.

Prindërit dhe bashkësitë lokale pjesëmarrësit dhe përfituesit e tjerë janë prindërit dhe bashkësitë lokale, autoritetet arsimore qendrore dhe regjionale. Ata do të kishin dashur të jenë më të përfshirë në planifikimin e programit arsimor të fëmijëve të tyre. Si rezultat, prindërit dhe bashkësia do të konsiderohen si përkrahje e rëndësishme për përmirësimin e kualitetit të intervenimeve arsimore. Bashkësia gjithashtu ka rëndësi kyçe në ngritjen e vetëdijës në lidhje me rëndësinë e arsimit përfshirës si një sektor i rëndësishëm i arsimimit publik. Përvoja ndërkombëtare tregon se sistemi i arsimit mund të jetë shumë rezistent ndaj NV. Prindërit janë mbrojtës të rëndësishëm për fëmijët e tyre në sigurimin e qasjes në arsim. Me qëllim që të përmbushet ky rol, ata duhet të bëjnë të mundur që politika nga organizatat e prindërve të jetë me vend.

OJQ-të dhe projektet e tjera ndërkombëtare (Banka Botërore dhe Agjensioni Kanadez për Zhvillim Ndërkombëtarë - AKZHN) janë pjesëmarrës të rëndësishëm. Bashkëpunimi i tyre mund të jetë i rëndësishëm në: zhvillimin e politikës së logjikshme për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në sistemin e rregullt. Kjo mund të ndodhë përmes zgjedhjes së personave të cilët do të marrin pjesë në kurset trajnuese për zhvillimin e resurseve njerëzore, hartimin dhe përmirësimin

gradual të plan-programit të trajnimit, zhvillimin e strategjive afat-mesme dhe afat-gjate të trajnimit, dhe angazhimin e të gjithë pjesëmarrësve të rëndësishëm për procesin e zhvillimit të politikës dhe të implementimit. OJQ-të dhe organizatat bashkëpunëtoreshë do të marrin pjesë si trajnues dhe organizues të aktiviteteve të ndryshme.

Sistemi Serb i Kosovës për arsimin e personave me aftësi të kufizuara (edhe nëse përfaqësohet nga një shkollë e vetme në enklavën serbe të Mitrovicës) mund të llogaritet si pjesëmarrës i ndarë, pasi që ka dallime në prioritete dhe interesa në krahasim me shumicën etnike.

3. QËLLIMET E POLITIKËS PËR SISTEMIN E ARSIMIT

3.1 Arsimitimi për të gjithë:

- Të lehtësohet qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në arsim, në aktivitetet e bashkësisë si dhe barazia në përgatitjen arsimore në të gjitha nivelet.
- Të garantohet qasja e barabartë dhe të ngritet vetëdija mbi arsimimin për të gjithë, në pajtim me parimet e të drejtave të njeriut.
- Të dekretohet legjislacioni i cili përkrah qasjen jodiskriminuese në arsim në kuadër të sistemit të arsimit përfshirës.

3.2 Sistemi i arsimit përfshirës

- Të zhvillohet një sistem i arsimit përfshirës (sistem unik i arsimit) për të gjithë, i cili do të plotësojë nevojat e nxënësve në kuadër të mjedisit përfshirës.
- Të lehtësohet qasja e hershme në arsim për të gjithë nxënësit, veçanërisht qasja e nxënësve me nevoja të veçanta në institucionet parashkollore, për të mundësuar intervenim sa më të hershëm.
- Të ekzistojë një planprogram detal (i plotë) për të gjithë. Në zhvillimin e planprogramit të angazhohen mësimdhënës për arsimimin e personave me nevoja të veçanta dhe pjesëmarrës të tjerë.

3.3 Ndërtimi i kapaciteteve në arsim/AG

- Të lehtësohet ndërtimi i kapacitetve për të gjithë pjesëmarrësit, i resurseve njerëzore dhe atyre institucionale.
- Të organizohet trajnimi i mësimdhënësve para dhe gjatë shërbimit në lidhje me arsimin përfshirës.
- Të përkrahen dhe fuqizohen prindërit dhe të rritet niveli i bashkërendimit dhe vetëdijes midis pjesëmarrësve në shërbime.
- Të përkrahen mësimdhënësit për të punuar në mjedise përfshirëse.
- Të përkrahen proceset kërkimore të efektshme dhe përkatëse në terren.

3.4 përgatitja arsimore

- Të ofrohen mjetet e nevojshme mësimore, përkrahja dhe hapësira e përshtatshme për mësim efektiv.
- Zhvillimin e përshtatshëm të teknologjisë për trajnim në arsim
- Përkrahje adekuate arsimore për të gjithë nxënësit.

4. PARIMET ARSIMORE/AGJ

Të gjithë njerëzit duhet të kenë qasje të barabartë drejt mundësisë për tu arsimuar, pavarësisht prej aftësive të tyre. Çdo nxënës ka aftësi dhe nevojë për të mësuar. Rrespekti për shumëllojshmëri duhet të theksohet dhe avancohet. Të gjithë njerëzit duhet të kenë qasje në të gjitha mundësitë e arsimit dhe ato shoqërore; të arsimohen dhe trajnohen në një mjedis sa më normal; të sigurohet barazia për nxënësit me aftësi të kufizuar përbrenda mjedisit përfshirës.

Idetë bazë të arsimit përfshirës mund të gjenden në shumë dokumente ndërkombëtare politike të mëhershme:

Konventat mbi të drejtat e femiut 1989

-e drejta e femiut me aftësi të kufizuar për t'u arsimuar dhe trajnuar - të arrihet niveli sa më i lartë i pavarësisë dhe integritit shoqëror

-Arsimimi duhet të përqëndrohet në zhvillimin maksimal të personalitetit, talenteve, si dhe aftësive fizike dhe mendore të femiut.

Deklarata Botërore e Jomtienit mbi arsimin për të gjithë 1990

-Arsimimi për të gjithë

-Dallimet individuale pranohen si sfidë e jo si problem

Rregullat Standarde mbi barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar 1993

-Autoritetet arsimore janë përgjegjëse për arsimimin e personave me aftësi të kufizuar në mjedise integruese: planifikimin arsimor, zhvillimin e planit mësimor si dhe organizimin e shkollimit.

Deklarata e Salamancas dhe Korniza për veprim e miratuar në Konferencën botërore mbi arsimin e personave me nevoja të veçanta 1994

-Shkollat duhet të përfshijnë të gjithë fëmijët pavarësisht nga gjendja e tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore, apo ndonjë gjendje tjetër.

-“arsimi i personave me nevoja të veçanta” i referohet të gjithë atyre fëmijëve dhe të rinjëve nevojat e të cilëve rrjedhin nga kufizimi i aftësisë apo vështirësive në të mësuar

5. GRUPET SHENJË

Grupe shenjë janë të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe nevoja të veçanta në arsim pa marrë parasysh gjininë, religjionin, grupin etnik, mendimet politike, mjedisi urban ose rural ose shkallën e dëmtimit. Vëmendje e posaçme duhet kushtuar qasjes në arsim në të gjitha nivelet duke përfshirë: të rriturit me aftësi të kufizuar, veçanërisht femrat; fëmijët; njerëzit me dëmtime intelektuale ose aftësi të kufizuar mendore; bonjakët; grupet e minoriteteve; fëmijët dhe të rinjtë që ndodhen në spitale ose institucione; dhe personat me aftësi të kufizuar që jetojnë në zonat rurale.

6. KËRKESAT E SISTEMIT TË ARSIMIT NË KOSOVË

Nevojat e veçanta në arsimim dhe trajnim ekzistojnë madje edhe jashtë klasës. Nevojat e veçanta në arsimim përfshijnë përkrahjen në formë të shkathtësive jetësore, trajnimit për pavarësim, pajisjes së veçantë dhe qasjes në planprogramin mësimor. Tradicionalisht, arsimimi është i përqëndruar në vitet e kaluara në shkollë

dhe jo aq shumë në arsimimin terciar. Arsimit njerëzit me aftësi të kufizuara duhet t'i pajisë me aftësitë e nevojshme për t'u mundësuar qasjen në tregun e punës. Lidhjet me tregun e punës dhe trajnimin deri më tani kanë qenë të dobëta. Ndryshimet në politikën e arsimit kanë një rëndësi të madhe për fuqizimin e ardhëm dhe ngritjen e statusit ekonomik të personave me aftësi të kufizuara.

Intervenimi i hershëm për të mirën e të gjitha grup moshave në kuadër të mjedisit përfshirës është shumë të rëndësishëm për zhvillimin e një shoqërie të integruar. Shqetësimet kryesore të personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga moshja, përfshijnë qasjen në mjediset arsimore, mungesën e transportit dhe mendimin negativ publik ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Për të realizuar qëllimet e sistemit të arsimit përfshirës janë të nevojshme elementet vijuese:

A) Intervenimi në fëmijërinë e hershme:

Intervenimi në fëmijërinë e hershme dhe të mësuarit, fëmijut me aftësi të kufizuara i mundësojnë qasje në arsim, mundësi për ndihmë dhe shoqërim që në moshë të hershme.

B) Arsimi primar

Të gjithë fëmijëve të moshës shkollare duhet t'u sigurohet arsimim i obligueshëm dhe pa pagesë. Familjeve të cilat kanë fëmijë me aftësi të kufizuara duhet t'u garantohet përkrahje nga bashkësia.

Aty ku sistemi i rregullt shkollor ende nuk mund të përshtatet në mënyrë të tillë që të mund të plotësojë nevojat arsimore të fëmijut me aftësi të rëndë të aftësisë, duhet t'u mundësojë qasje në klasë apo shkolla të veçanta (speciale). Kjo, sidoqoftë, gjithmonë duhet bërë me qëllim të përgatitjes së nxënësve për t'u arsimuar në sistemin e rregullt shkollor sa më shpejt që është e mundur. Nxënësi në shkollë speciale duhet të mbajë lidhje të ngushta me bashkësinë lokale të tij / saj.

C) Arsimi i mesëm

Institucionet e arsimit më të lartë për momentin janë duke iu nënshtruar transformimit në të cilin duhet të merren parasysh nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Kujdes të veçantë duhet kushtuar veçanërisht ofrimit të trajnimit profesional (zanatit) në të gjitha shkollat, në mënyrë që nxënësit të pajisen me shkathtësitë për të cilat kanë nevojë.

D) Arsimitimi dhe trajnimi i të rriturve

Qasja në arsimimin dhe trajnimin e të rriturve është bazë për lirinë ekonomike të të rriturve me aftësi të kufizuara. Udhëzuesit politikë për arsimimin dhe trajnimin e të rriturve duhet të ofrojnë kushte për nevojat e veçanta të të rriturve me aftësi të kufizuara që janë përfshirë në mësim.

E) Arsimi i lartë

Institutet e arsimit të lartë për momentin janë duke iu nënshtruar një periudhe të transformimit. Janë duke u vënë në zbatim (për herë të parë) fakultete dhe studime të reja.

Qasja në arsimin e lartë personave me aftësi të kufizuar u siguron të gëzojnë mundësi të barabarta.

Udhëzuesit politikë për arsimin e lartë duhet të pasqyrojnë bashkëpunimin dhe partneritetin ndërmjet arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera shoqërore.

Reagim më të madh ndaj nevojave ekonomike dhe sociale.

7. REKOMANDIMET POLITIKE

Në mënyrë që të arrihen qëllimet e politikës, është e nevojshme të veprohet në fushat kyçe:

Të zhvillohet një politikë e qartë që përfshinë të gjithë bartësit e shërbimeve dhe që kuptohet dhe pranohet në nivel shkollor dhe nga bashkësia.

Të zhvillohen strukturat institucionale, siç janë mekanizmat e bashkëpunimit efektiv ndërmjet Departamentit të Arsimit dhe Shkencës, komunës, shkollës, dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuar.

Të ngritet vetëdija publike mbi nevojat, të drejtat, dhe mundësitë e personave me aftësi të kufizuar (përmes mediave, publikimeve etj)

Të ofrohet arsimim për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar në kuadër të arsimit të rregullt me parapërgatitje adekuate të mjediseve speciale për fëmijët me kufizim të rëndë të aftësisë.

Të zhvillohet një plan mësimor i cili siguron fleksibilitet dhe përshtatje në pajtim me nevojat nxënësit, pavarësisht nga aftësia e kufizuar.

Të ofrohen libra adekuate si dhe materiale për mësimdhënie dhe për të mësuar për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Të garantohet trajnimi i vazhdueshëm i cili është në zhvillim e sipër në arsimin special dhe përfshirës për profesionistët, siç janë mësuesit, drejtorët, administratorët, dhe planifikuesit (duke u siguruar ndër të tjera përkthimin e literaturës relevante profesionale në gjuhën shqipe)

Të inkurajohet pjesëmarrja e prindërve në vlerësime dhe vendim marrje që ka të bëjë me fëmijët e tyre.

Të ofrohet arsimim i përshtatshëm – shërbime përkrahëse përfshirë teknologjinë përkatëse për të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuar.